



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 08/06/2026.
PRIMLJENO:
02/166



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-IV- (katër) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- (tretë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës, të mbajtur më datë 30.04.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 01/755, datë:13.05.2026, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Memorial Përkujtimor të fshatit-Lapidarit për dy Dëshmorët e Kombit, në fshatin Gurbardhë, Komuna e Malishevës.
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës së Malishevës për periudhën janar - dhjetor 2025.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. nr 04/254, datë 04.05.2026, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin fiskal 2026.
5. Rishqyrtim i vendimit nr. 02/87 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/359, 6. datë 11.08.2022, për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, konform shkresës zyrtare të MAPL-së, nr.020-742/17, datë: 04.05.2026.
6. Propozim për ndryshimin e Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës.
7. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në bujqësi në Komunën e Malishevës.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/110, datë 10.04.2026, për iniciimin e procedurës për kompensim të pronës.
9. Të ndryshme.

Koha:21.05.2026,ora09:15

Vendi:Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 21 Asambleistë,Drejtori për Administratë të Përgjithshme z.Argjend Thaçi, Drejtori për Urbaznizëm z.Avdi Morina,Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Nuredin Hoxha,Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi,Drejtori i

Inspektoriati z.Jakup Gashi,Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani,Drejtori për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukolli,Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm z.Arbër Kastrati,Drejtoresha për Prona znj.Mirlinda Gashi,zyrtar ligjor z.Muharrem Morina.

Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati.

Zyra për informim.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Fatmir Ademaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Përshëndetje!Mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër të rregulltë të Kuvendit Komunal ne kemi korumin e mjaftueshëm për të filluar me seancën e rradhës e hapi debatin jashtë rendit të ditës në periudhën kohore prej tri dhjetë minuta për Asambleistët.

Bashkim Krasniqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma):Përshëndetje!Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal të Malishevës,të nderuar Drejtorë të pranishëm,qytetarë të nderuar të komunës së Malishevës.Fillimishtë shfrytëzoj rastin që ti urojë Klubit të qytetit që prapë të marrë pjesë në garat Evropiane kjo është një arritje e madhe sepse që tri herë rradhazi është duke marrë pjesë në garat Evropiane dhe unë i urojë suksese në këto gara.

Kryesues herën e kaluar e kam parë mënyrën se si i keni shpërndarë llaptopat ngjanë disi në një mënyrë private që për mendimin tim nuk është në rregullë.Kjo është hera e para për të cilën unë jam duke folur për këtë qështje dhe nuk do të flasë më sepse nuk është ndonjë problemë i madh se a kemi apo nuk kemi llaptopë,ne nuk kemi hyrë këtu që gjithësesi ne duhet me pasur llaptopin përpara por ne jemi të barabartë këtu dhe unë e bëj një kërkesë që duhet me i shfrytëzuarë të gjitha mundësitë me të cilën unë nuk dëshiroj me ju hedhur fajin juve por shfrytëzoni të gjitha mundësitë që të bëhetë kthimi i atyre llaptopëve me të cilën duhet bërë një pranim dorëzim,kontrollimi teknik dhe pastaj ti dorëzohet personit tjetër.

Mendoj që nuk është mirë që ndonjërit me ja vendosur një qantë me llaptopin aty tek ulësja e dikujt tjetër jo por verifikojeni kush nuk e ka kthyer llaptopin cekeni dhe përmendeni me emra sepse nëse është pronë e komunës e ka për obligim që pasi e ka kryer mandatin menjëherë me kthyer dhe pastaj me një shkresë zyrtare me u bërë pranim dorëzimi i llaptopëve është hera e parë që jam duke folur për këtë qështje dhe nuk do të flasë më.

Kjo qështje ishte dashur të përfundohet në seancën e parë sepse nëse dikush është i papërgjegjshëm dhe nuk e kthenë ne nuk duhet me u bërë neglizhentë dhe mos me përfunduarë punën tonë,qështja tjetër është që kërkoj nga Drejtoritë përkatëse në këtë rastë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria e Inspektoriatit me bërë një raportë që kemi të bëjmë me një problemë të kanalizimit i cili është bllokuarë te hyra e oborrit të shkollës në fshatin Tërpezë sepse aty kemi lëvizje të nxënësve aty kanë qenë me vizituarë formalishtë vetëm Hidro rregjioni dhe nuk kanë bërë asgjë,kërkoj që të bëhetë një raportë dhe të mirren masat për shkakë që aty është një vend i ndjeshëm dhe mundë të shfaqen infeskione shkaku i asaj gjendje.Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Një pjesë e madhe e ish Asambleistëve që kanë qenë në mandatin e kaluarë i kanë kthyer dhe për mos me i mbajtur në zyre kam vendosur që për grupet parlamentare të PDK-së dhe LVV-je me i përfunduarë pasatj kam filluar me grupin e Nismës dhe LDK-ja ende nuk ka marrë llaptopa do me thënë kam shkuarë fillimishtë me opozitën,besoj që deri

në mbledhjen e ardhshme të gjithë ata të cilët nuk i kanë sjellur përmes grupeve parlamentare të ju kërkojnë që ti sjellin lllaptopin,unë nuk kam ndonjë mekanizëm detyrues që ti publikojë emrat e atyre që uk i kanë kthyer pas kësaj seance.Faleminderit.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Përsëritje Drejtorë,të nderuar kolegë Asambleistë,unë nuk dëshiroj me zgatur shumë i ka tri qështje dy prej tyre janë që lidhen me veprimet e shëndetësisë dhe një me qështjen e arsimit që Drejtoresha e Arsimit nuk qenka këtu.Drejtorë sa jeni i informuar për nivelin e papastëritë në Emërgjencë nga stafi juaj?A ju kanë dërguarë disa foto dhe video nga ato tualete dhe disa hapësira të tjera?Dëshiroj me ditur kush është kontraktorë për mirëmbajtjen dhe kujdesin e atyre hapësirave në QKMF?

Qështja e dytë ka të bëjë me fushatën që keni nisur me dizinfektimin në zona endemike,nëse ka mundësi me na dhënë informacion.Cila është ajo kompani që po i kryenë këto shërbime deri kur e ka komuna këtë kontratë dhe a është duke shkuarë sipas planit të cilën e kanë para parë?Sepse mendoj që jemi vonë me këtë procesë.Drejtoresha e Arsimit nuk është këtu,unë po e përsërisë pse nuk janë duke shpallur konkursë publikë.pse janë duk e zvarritur këtë qështje?Meqenëse nuk është prezente Drejtoresha mirëpo është mirë që ju Drejtorië me ja përcjellur këtë pyetje dhe me na dhënë të paktën përgjigje me shkrim.Faleminderit shumë.

Gazmend Begaj(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përsëritje të nderuar Asambleistë,i nderuar Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastrati,i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj,të nderuar Drejtorë dhe ju të pranishëm sot dëshiroj me i ngritur disa qështje dhe shqetësime që kemi të bëjmë me kushtet dhe jetesën e banorëve në fshatit tonë të Banjës,ndër problematikat më të mëdhaja që i kemi në Banjë është një kërkesë që në vazhdimësi po adresohet për Hidro rregjionin kompania e cila merret me menagjimin e furnizimit të ujit,janë disa lagje në fshatin Banjë që kanë problemë me frunizimin e ujit të pijshëm,problematikë tjetër është qështja e kanalizimit me të cilën kemi adresuar kërkesa në vazhdimësi në Drejtorinë për Shërbime Publike me të cilën është kontaktuarë edhe Hidro rregjioni i cili është përgjegjës për bllokimin e kanalizimeve bujqësore me të cilën nuk e kanë kryer punën si duhet dhe ky është një problemë për fshatin tonë.Faleminderit.

Burim Paqarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përsëritje Drejtorë,Kryesues,koleg Asambleistë,të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës.Unë nuk dëshiroj me zgatur shumë i kam tri pika të cilat kam i trajtuarë pjesa e parë ka të bëjë me rrugët lokale të cilat janë në përgjegjësi të komunës me të cilën unë me sa e di është një kontratë aktive për mirëmbajtjen e rrugëve lokale,kisha dashur me ditur deri ku është niveli i saj,si është kontrata e saj duke e pasur parasyshë që niveli i rrugëve tonë është jashtë zakonishtë shumë keqë me të cilën secili prej neve përballet me këto rrugë.

Si pikë e dytë është ndriqimi publikë,kontrata është aktive e cila është nënshkuarë vitin e kaluarë.A kanë filluar këtë vitë me vendosur drita?Ne kemi vazhdimishtë thirje nga qytetarët që na thojnë se punimet nuk kanë filluar ende dhe dëshirojnë që me u rregulluarë ndriqimi publike sepse është shumë i rëndësishtë në këto ditët e verës.Qështja tjetër me të cilën e ndëgjova edhe nga kolegët e cila është shumë brengosëse është qështja e kanalizimit me të cilën ajo është në nivelin jo të duhur,pajtohem me kolegun tim që në fshatin Banjë para se me ardhur në Malishevë aty kundërmonë jashtëzakonishtë një aromë e pakëndshme,gjithashtu edhe në fshatin Guriçë,në fshatin Dragobilë ka ende shtëpi banimi që mbi 500 metra me të cilën unë e ka një propozim që

tek të hyrat vetanake të investojnë në kanalizim mbi 500 metra sepse disa shtëpi nuk kanë qasje fare në kanalizimin kryesorë,këto ishin disa pika që dëshirova me i trajtuar.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Rendin e ditës e keni pranuarë me kohë a ka dikushë propozim për rendin e ditës?Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përshëndetje për të gjithë!Sa i përketë rendit të ditës.Unë me kërkesë të Drejtorit të Bujqësisë pika me numër shtatë të rendit të ditës e cila është: Shqyrtimi i raportit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në bujqësi në Komunën e Malishevës,të vendoset si pikë e katër e rendit të ditës për shkakë që ai ka takimë dhe të vendoset menjëherë pas Raportit të Kryetarit të Komunës.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.A ka dikush propozim për rendin e ditës.Fjalën e ka kërkuarë z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesus.Unë e kam një pyetje për ju kolegë Asambleistë nuk e di a ju ka ardhur material për kërkesën 02/110 për kompenzim të pronës pra për ndrim destinim të pronës të z.Abedin Mazreku,unë e kam vetëm kërkesën nuk kam material tjetër,nëse nuk është e kompeltuarë kompeltë kërkesa me dokumentet përkatëse kërkojë që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë dëshirojë të ndrëlidhem me fjalimin e kolegut Vetonin.Unë e kam parë që kërkesa nuk është e kompletuarë mirëpo meqenëse ajo është në rendin e ditës,unë propozojë që me lënë këtë pikë të rendit të ditës dhe kur vie me rradhë me u trajtuarë ne mundemi me shtyerë apo refuzuarë për shkakë që nuk është e kompeltuarë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Për këtë pikë me të cilën e diskutuanë z.Vetoni dhe z.Halili e kemi diskutuarë edhe në mbledhjen e KPF-së ashtu siq kemi marrë vlersim fillestarë të gjitha kërkesat që trajtohenë në KPF dhe kalojnë në KPF vijnë në Asamble Komunale në rendin e ditës dhe në momentin kur kërkesa nuk ka materialin e kompeltuarë shtyhet kërkesa derisa të kompeltohetë kërkesa.Ne kemi kërkuarë nga pala që ta kompeltojë kërkesën mirëpo pala nuk e ka kompletuarë dokumentacionin dhe ne kur arrijm për trajtim tek pika e tetë te kjo kërkesë ne duhet me shtyerë këtë pikë derisa të përmbushen obligimet ligjore të palës përballë Asamblesë Komunale.Ndërsa sa i përketë kërkesës së z.Halilit për ndryshim të pikave të rendit të ditës,fillimishtë e vendosi në votim si propozimin për ndryshim të pikave të rendit të ditës,që pika e shtatë të kalojë në mënyrë kronologjike si pikë e katër e rendit të ditës.Kush është për?

Rezultati i votimit:21 për,0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se propozimi për ndryshimin e rendit të ditës u miratua.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kush është për këtë rend të ditës në tërësi të cilën e kemi?

Rezultati i votimit:21 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimishtë miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- (tretë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës, të mbajtur më datë 30.04.2026.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës nëse keni ndonjë vërejtje, trajtim apo kërkesë rreth procesverbalit. Meqenëse nuk ka dikush me marrë fjalën e hedhi në votim. Kush është për?

Rezultati i votimit: 21 për, 0 kundër, 0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se procesverbali nga mbledhja e III-të e rregulltë u miratua unamishtë.

Pika 2

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 01/755, datë: 13.05.2026, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Memorial Përkujtimor të fshatit-Lapidarit për dy Dëshmorët e Kombit, në fshatin Gurbardhë, Komuna e Malishevës.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka me marrë fjalën dikush nga anëtarë e ekzekutivit para se me vazhduarë me anëtarë e Asamblesë Komunale për trajtimin e kësaj kërkesë? Atëherë e hapi debatin. Fjalën e ka kërkuarë z.Bashkimi

Bashkim Berisha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesusi. I nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar kolegë Asambleistë. Sa i përketë kësaj kërkesë e cila ka ardhur nga Kryetari i Shoqatës së Dëshmorëve dhe ka ardhur te Kryetari i Komunës për ndërtimin e një objekti Memorial dhe Lapidarit të Dëshmorëve. Unë kërkojë nga kolegët Asambleistë që ta përkrahin këtë pikë me të cilën aty do të ndërtohet një Memorial i jashtë zakonishtë në fshatin tonë dhe është me vetë financim të fshatit dhe shpresojë që do të kalohetë kjo pikë.

Burim Paqarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përshëndetje për të gjithë. Ne si Parti Demokratike e Kosovës i vlerësojmë lartë kontributin e të gjithë dëshmorëve të kombit, kjo pikë e cila ka ardhur është e rëndësishme për fshatin Gurëbardhë por edhe të gjithë banorëve të tjerë të Malishevës. Ne e vlerësojmë lartë këtë kërkesë shpresojë që kjo do ta rregullojë dhe do ta zbkurojë edhe më shumë ambientin. Faleminderit.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesusi. Unë e mbështeti iniciativën e Shoqatës së Dëshmorëve për ndërtimin e objektit Memorial. Lavdi për të gjithë dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Unë urojë që këto lloj iniciativa në të ardhmen të kryehenë nga institucionet e Komunës dhe nga niveli qëndrorë që ne ta pasurojmë akoma më shumë kujtesën tonë. Aleanca e mbështetë këtë kërkesë për ndërtim e këtij objekti të rëndësishëm që brezat e ardhshëm do ta kujtojnë.

Kërkesa ime është që kjo jo vetëm të kalohet si qështje procedurale por nga ky momentë besojë që do ta merrë miratimin nga të gjithë Asambleistët që janë këtu. Faleminderit.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Ne si grup parlamentarë e mbështesim kërkesën dhe iniciativën për ndërtimin e objektit Memorial në fshatin Gurëbardhë vetëm kërkojmë që para se të realizohet projekti, Drejtorit përkatëse ti marin masat ligjore që të

jemi në rregullë,të përcaktohetë lokaliteti dhe të futet pastaj si pronë në mirëmbajtje në agjensinë Memoriale ose në Komunën tonë që të jemi në aspektin ligjorë korrektë dhe mos të kemi pastaj probleme të tjera.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokratike):Përshëndetje Kryetar,Kryesus,Drejtorë,të nderuar Asambleistë,të nderuar qytetarë të Malishevës.Iniciativat e tilla duhet me i përshëndetur dhe janë për lakmi.Ne si zëri i qytetarëve të Komunës së Malishevës i inkurajojmë dhe e mbështesim plotësishtë këtë kërkesë,meqenëse ne si institucion i komunës jemi duke ja ndarë këtë hapsirë të madhe në 56 ari,nënkuptonë që ne jemi vetë pjesëmarrës aty,e mbështeti z.Zogaj,gjithashtu drejtoritë përkatëse të jenë në dispozicionë të këtij monumenti që legjislacioni të jetë si model edhe në fshatrat e tjera që edhe bashkësitë lokale ti nisin hapat e tillë,me folur për luftën nuk kam qfarë të flasë sepse unë vetë kam qenë pjesë e luftës,por brezat e ri që vijnë do ta marin një lloj frymëzimi për qështjen kombëtare.Malisheva ka qfarë të flas për luftën sepse ka dhënë kontributë.Unë ndihem shumë i privilegjuarë që do të ja jap votën time pro.Faleminderit.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Përshëndetje Kryeus,Kryetar i Komunës,Drejtorë,kolegë Asambleistë.Fillimishtë i përgëzojë banorët në fshatin Gurëbardhë dhe Shoqatën e familjeve të Dëshmorëve të Kombit për iniciativën,natyrishtë që do ta ketë mbështetjen e plotë të Lidhjes Demokratike të Kosovës,iniciativat dhe kërkesat e tilla gjdo herë do ta kenë mbështetjen e LDK-së.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.A ka dikush tjetër nga anëtarët e Kuvendit me marrë fjalën?Në të njejtën kohë edhe unë si Kryesus i bashkangjitem kësaj kërkesë dhe uroj që sa ma shumë të ketë kërkesa të tilla për kontributin që kanë dhënë në luftë sepse sot duke i nderuar kërkesat e tilla i nderojmë dëshmorët e kombit.Kush është për?

Rezultati i votimit:21 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimishtë miratoi kërkesën.

Pika 3

Pika e tretë:Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës së Malishevës për periudhën janar - dhjetor 2025.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë Kryetarit të Komunës z.Ekrem Kastratit.

Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastarti:Përshëndetje i nderuar Kryesus,të nderuar Asambleistë, Drejtorë,të nderuar stafi i Administratës.Ju falenderojë që sot ma keni dhënë mundësinë që në rendin e ditës ta prezentojë punën vjetore me të cilën është edhe obligim ligjorë por sigurishtë që kemi obligim edhe ndaj qytetarëve dhe institucioneve që ta raportojmë punën tonë.Raporti i Punës së Kryetarit dhe veprimeve komunale të Komunës së Malishevës është në përputhje me kërkesat që dalin nga ligji për vetëqeverisje lokale,statusin e Komunës së Malishevës dhe me aktet e tjera ligjore dhe si rrjedhorë e kësaj i gjithë angazhimi i Kryetarit të Komunës dhe organeve të tjera komunale gjatë periudhës së raportimit janar-dhjetor 2024 ka qenë në funksion të respektimit të rendit të ligjit dhe disiplinës.

Ky raportë pasqyronë një përmbledhje të disa projekteve që kemi realizuarë gjatë këtij viti si qeverisje komunale,disa janë realizuarë kurse disa të tjera janë në procesë e sipër të cilat janë gjithmonë konformë akteve kohore të parapara.Ky raportë paraqetë në mënyrë të drejtë për drejtë

punën e cila është realizuarë gjatë këtij viti të arriturat projektet e përfunduara të cilat mbeten sfida që kërkojnë ende zgjidhje.

Vitin të cilën e lamë pas ishte vitë i angazhimit dhe përpjekjes për të përmirësuar jetën e qytetarëve tanë,ndër arritjet më të suksesshme ka qenë përmbyllja e një projekti më të ndjeshëm Malisheva Urbane i cilin përfshinë bulevardin,parkingun nëntokësorë,sheshin e dëshmorëve dhe rregullimin e infrastrukturës përcjellëse ky investim ka ndryshuar jo vetëm pamjen e qytetit por edhe hapsirën publike duke i bërë ato më funksionale, më kreative dhe më të përshtatshme për qytetarët tanë pa dallim.

Disa nga projekte të tjera të cilat janë realizuarë janë:vazhdimi i asfaltimit në disa rrugë lokale dhe mirëmbajtja e tyre nëpër disa fshatra dhe qytet,asfaltimi i rrugëve 1.4 km,ndërtimi i trotuarëve 1.05 km,ndërtimi i ndriqimit të lartë 1.4 km,punimi i kanalizimit 6 km,shënjestimi horizontal dhe vertikal 1.4 km,hapërisa gjelbëruese 1350 m²,hapërisa e sheshit 9874 m² dhe parkingu nëntokësorë për 200 vetura.Ndërtimi i objektit të shkollës në fshatin Turiak është përfunduarë mirëpo është në përfundim e sipër palestra sportive.Trajtimi dhe renovimi i rrjetit të kanalizimit nëpër fshatra është si projekt dy vjeçarë dhe ka vazhduarë për renovimin dhe funksionalizimin e tyre,renovimi i rregullimit të ujërave të zeza ka filluarë fazën e parë në fshatin Bubël,Lumishtë në lartësi prej 2.5 km kanë filluarë punimet.

Ndriqimi publikë ka filluarë në disa fshatra dhe qytetë.Renovimi i disa objekteve në shkolla dhe në qytetë.Ndërtimi i rrugës "Sabit Berisha" dhe rregullimi i palestrës sportive janë në fazën e përfundimit të shtrimit të asfaltit,trotuarët vetëm se janë duke u përfunduarë dhe pritet të vendosin edhe shtresën e dytë,janë duke vazhduarë mirëmbajtja e rrugëve në sezonën e verës dhe dimrit,mirëmbajtjet verore janë mirëmbajturë 42 km rrugë lokale dhe urbane,mirëmbajtja dimërore e cila është mirëmbajtur gjatë këtij dimri i cili shkojë janë 125 km rrugë urbane dhe lokale,ndërtimi i rrugës të ujëvara e Mirushës në fshatin Llapqevë është një projektë që është financuarë nga Ministria e Infrastrukturës,ndërtimi i dy anëve të lumi Mirusha në qytet është një projektë me të cilën ende janë duke vazhduarë me punimet.

Ndërtimi i objektit të Ambulancës në fshatin Kjevë është një projektë me bashkë financim me Katarqarin dhe Komunën e Malishevës e cila e kap vlerën në shumën prej 350,000.00€.

Ndërsa sa i përket shpenzimit të buxhetit vazhdojmë me qenë komuna më e mirë në planifikim dhe realizim të investimeve kapitale dhe të shpenzimeve në kategorinë buxhetore.Sipas shenimeve nga libri i thesarit rezultojnë që shkalla e shpenzimeve të buxhetit të realizuarë për periudhën janardhjetor 2025-të është 99% kurse përqindja e tërsishme e buxhetit është shpenzuarë në këtë periudhë është po ashtu 99%,Sa i përket të hyrave kemi tejkalim në vitin që e lamë pas,sipas shënimeve aktuale në periudhën janar-tetor 2025-të përqindja e realizimit të hyrave në krahasim me planifikimin është 111%.

Në sektorin e bujqësisë përmes bashkëpunimit me donatorët siq janë Islamik-Relief,Katarqarit kemi vazhduarë përkrahjen për fermerit e komunës tonë,kjo përkrahje është reflektuarë në përkrahje konkrete në subvencione dhe mbështetje me mjete bujqësore duke ndikuarë në rritjen e prodhimit dhe forcimin e ekonomive familjare në fshatrat e komunës tonë disa nga sektorët që janë përkrahur janë paraqitur si më poshtë:përkrahje të ndara në subvencionim me pagesë direkte janë përkrahur 112 qytetarë në vlerën prej 26,456.00€,përkrahja e blektorëve me subvencionim të qumështit përmes pagesës direkte kanë përfiturë 103 fermerë të cilët dorzojnë qumështin në pikat

grumbulluese të qumshtit në vlerë prej 45,267.00€, subvencionimi i fermerëve me pagesë direkte për blektori siq janë delet dhe dhitë si dhe për buallica kanë përfituarë 49 fermerë me dele, dhi si dhe 2 fermerë për buallica në vlerë prej 26,082.00€.

Ndërtimi i serave për fermerët përfitues nga bashkëpunimi Islamik-Relief Kosova janë ndërtuarë 58 sera në sipërfaqe prej 50 m² dhe 15 sera në sipërfaqe prej 100 m². Ndarja për mekanizimin bujqësorë për fermerët në bashkëpunim me shoqatën Islamik-Relief janë shpërndarë 50 multikultivatorë, 25 spërkatëse, 15 makina për mbledhjen e misërit, 13 makina për mbledhjen e grurit dhe 27 prerëse.

Në sektorin e shëndetësisë po ashtu me Katarqarin është ndërtuarë Ambulanca e re në Kijevë e cila ka përmirësuarë qasje në shërbime shëndetësore për qytetarët e asaj ane është një investim i rëndësishëm që ka kontribuarë drejtë për drejtë në mirëqenien dhe lehtësimin e barabartë për të gjithë qytetarët e komunës tonë dhe më gjerë.

Gjithashtu ka vazhduarë përkrahja edhe në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe AMF-të nëpër fshatrat e komunës tonë. Kemi vazhduarë mbështetje për organizatat joqeveritare rinore dhe sportive të cilat janë aktive në komunën tonë duke krijuarë mundësi më të mira për angazhimin e të rinjëve për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore që i mbanë të lidhur rinin tonë me qytetin e tyre duke e pasuruar jetën kulturore e sportive në Malishevë. Në sektorin e arsimit kanë vazhduarë investimet në projektet që kanë fokusë përmirësimin e kushteve në shkolla dhe ngritjen e cilësisë në procesin mësimorë.

Kemi vazhduarë traditën e krijuarë që nga marrja e mandatit të jemi të hapur dhe sa më transparentë ndaj qytetarëve duke raportuarë për punën tonë dhe duke qenë të gatshëm të dëgjojmë kërkesat dhe shqetësimet e tyre përmes takimeve të shumta me ta qoftë në zyren time apo gjatë vizitave në terren, pasi që besojmë që vetëm përmes bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me ta mundë të arrihen rezultate të qëndrueshme në të mirë të komunës dhe gjithmonë në interesë të qytetarëve.

Me insistimin tonë të vazhdueshëm përmes takimeve të shumta me kompanin për energji elektrike KEDS kemi ngritur nevojën për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike në komunën e Malishevës e që gjatë vitit të cilin e lëmë pas kemi ngritur nivelin e bashkëpunimit me ta duke u fokusuarë që interesi i qytetarëve të jetë përmirësimi i furnizimit me energji elektrike.

Si rezultat i kërkesave tona dhe bashkëpunimi korrektë janë investuar kabllotë e rrjetit nga kjo kompani e që ka ndikuarë drejtë për drejtë në stabilizimin e furnizimit dhe duke e reduktuarë ndërprerjen e energjisë elektrike në këtë mënyrë kanë krijuarë kushte më të mira jetese për familjet dhe bizneset. Ky është një hap i drejtë i bashkëpunimit institucional me të cilën ka ndikuarë drejtë për drejtë në jetën e qytetarëve të komunës tonë.

Në anën tjetër furnizimi me ujë të pijshëm mbetet një sfidë serioze në vitin që e lamë pas por do të jetë sfidë edhe për këtë vitë dhe vitet e ardhshme e që ne gjithmonë do të mundohemi me bashkëpunuarë me institucionet e tjera relevante përkatëse edhe me donatorë të ndryshëm nuk do të lëmë derë pa trokiturë për ta realizuarë këtë nevojë të jashtëzakonshme për qytetarët tanë. Raporti i paraqitur para juve nuk është vetëm një përmbledhje e aktiviteteve dhe punës që e karakterizojnë për vitin që e lamë pas por një pasqyrë reale e punës tonë me rezultate konkrete por me sfida që kërkojnë angazhim të më tutjeshëm.

Ndër sfidat më të mëdha vazhdonë të mbetet borgji i cili është krijuar nga kontrata kolektive gjë e cila është duke na pamundësuar kalimin në projektet e palnifikuara, pasi siq e dini mjetet merren nga të gjitha kategoritë e punës pasi që nuk kemi ndonjë kod të veçantë për realizimin e këtyre pagesave.

Të gjitha projektet të cilat nuk kanë arritur të përfundohenë sipas planifikimit dhe sipas afatit kohorë të premtuarë për qytetarët dhe para jush ato tani më janë vonuarë punimet për shkakë të detyrimeve që kanë dalur nga kjo kontratë, e që mbetet pengë realizmi i tyre.

Ne do të vazhdojmë të punojmë me të njejtin përkushtim për projektet që sjellin ndryshim të mirëfilltë dhe përmirësim të drejtë për drejtë për jetesën e qytetarët tanë. Më poshtë i gjeni raportet e detajuara për secilin sektorë të paraqitur nga secili drejtorë i drejtorive përkatëse.

Faleminderit për vëmendjen dhe angazhimin tuaj gjithësesi.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit i nderuar Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastrati.Urojë që edhe ky vitë të jetë i punës dhe angazhimit maksimal i qeverisjes komunale.Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues për fjalën.Faleminderit Kryetar i Komunës për elaborimin e këtij raporti,jo vetëm për admirimin por edhe për punën e jashtëzakonshme që e keni bërë në mandatin e kaluarë,specifikishtë në vitin 2025-të për raportin të cilin jemi duke e shqyrtuar ne sot këtu edhe pse ka qenë një vitë zgjedhorë dhe dihetë që në vitet zgjedhore të zgjedhjeve lokale angazhimi më i madh bëhet në fushata zgjedhore,mirëpo ajo qfarë ne e pamë në raportë por jo vetëm në raportë por edhe ajo që vërehet në terrenë,pra ka qenë një aktivitet dhe një punë e jashtëzakonshme e Kryetarit të Komunës dhe stafit të tij në përgjithësi po thujse në të gjitha aferat ku manifestohet jeta njerëzore brenda Komunës së Malishevës duke filluar në arsimi,shëndetësi,bujqësi,infrastrukturë e kështu me rradhë.Kur flasim për infrastrukturën Kryetari e përmendi projektin në detaje me të cilën nuk e shohë të nevojshme me i përsëritur por që nuk ka diskutim që kulmi i gjithë asaj është projekti Malisheva Urbane,projekt i cili brenda saj ka një numër të madh të projekteve siq janë lirimi i hapsirave publike,shtrimi i asfaltimit të rrugëve,rreth rrotullimi,parkingu nëntokësor,nënkalimi për kombësorë të cilat përveq që e kanë bërë më funksional qytetin tonë e kanë shtuarë edhe dienzionin estetikë.

Zhvillime aktivitete të mëdha në shëndetësi mbi dy qind e gjashtë dhjetë mijë shërbime shëndetësore,ajo qfarë është më mbresëlënëse për mua një qeverisje e mirë vlerësohet në bazë të aftësisë së saj për me shpenzuarë buxhetin për investime kapitale.

Ta shpenzoshë buxhetin 99% me të vërtetë është për admirim,madje Kryetari z.Ekrem Kastrati nuk është ndalurë vetëm me këtë me shpenzimin e buxhetit të vetë por ka gjetur edhe mënyra të tjera përmes fondeve për të rritur buxhetin.

Ne e vërejtëm në raportë se sa subvencionime janë bërë në shëndetësi e gjithë kjo është falë bashkëpunimit të Kryetarit z.Ekrem Kastrati dhe stafit të tij me organizata të ndryshme siq janë Islamik-Relief of Kosoa,Katarqaritet e shumë të tjera.

Pra nëse një qeverisje e mirë vlerësohet në bazë të shpenzimit të buxhetit për investime kapitale,një qeverisje sigurishtë e mirë është kur edhe këtë buxhetë e shtonë falë bashkëpunimit që ka me organizata të tjera.

Ajo qfarë është shqetësuese për të gjithë ne,por edhe në gjdo vend tjetër të botës nevojat janë gjithmonë më të mëdha se sa mundësitë financiare.Por tek ne janë shumë fishë dhe shumë më të mëdha nevojat se sa mundësitë financiare.

Kur e shtojmë këtë dhe fenomenin e procedurave përmbartimore si pasojë e kontratës kolektive,kjo jo vetëm në komunën tonë por në shumicën e komuna të tjera ju është vu një lloj kolapsi. Shpeshë herë ne kur para rendit të ditës ngrisim shqetësime për shumë nevoja që ka në vendbanime të ndryshme në komunën e Malishevës,në opinionin publik nganjëherë krijohet bindje që Komuna e Malishevës është duke neglizhuarë i ka mbyllur sytë nuk dëshironë dhe falë vullnetit të saj nuk dëshironë me i realizuarë ato.Mirëpo ky konstruksion është tërësishtë i pa vërtetë sepse nuk ka asnjë lidhje ajo me realitetin.

Ne si anëtarë të Kuvendit e kemi për obligim me ju treguarë qytetarëve tabllonë e plotë,këto nevoja duhet me i vendosur në kontekstin e mundësive tona financiare.Kur i hudhim në kontekstin e mundësive tona financiare atëherë ne e kemi më të kjartë se sa e vështirë është sot me realizuarë një projektë dhe aq më tepër kur me ndryshimin e formatit të prokurimit,përderisa në të kaluarën ju keni mundur me nisur procedura të prokurimit ende pa i zotuar mjetet e derisa janë përfunduarë procedurat ju i keni gjetur mjetet ju keni filluar me projektë,tani nuk mundemi me filluar me një projektë pa i zotuarë mjetet,kjo akoma më shumë e vështirësonë realizimin e shumë shqetësimeve të cilat secili prej neve dalim dhe i ngrisim këtu jashtë rendit të ditës.

Për mos me zgjatur më shumë unë e inkurajojë Kryetarin e Komunës të vazhdojë me këtë punë,ajo qfarë e kam si vërejtje për raportin e që konsiderojë që sipas bindjes time për shembull janë disa vërejtje të cilat figurojnë të realizuara shpenzimet janë kryer por që realishtë puna në terren nuk është kryer.

Ne e dimë që kjo është si pasojë e kontratës kolektive,mirëpo për mos me shkaktuarë konfuzion te qytetarët sepse nëse hynë një qytetarë në veb faqe dhe e lexonë raportin sepse ky është material publik dhe e lexonë raportin aty për rregullimin e oborrit të shkollës në fshatin Astrazub i realizuarë,të hollat janë shkuarë për atë punë atij i krijohet bindja ore ajo punë nuk është kryer ai e kuptonë,mirëpo do të ishte mirë me vendosur një fusnotë me specifikuarë me treguarë që kjo ka ardhur si pasojë e përmbartimit për shkakë të kontratës kolektive dhe kjo e bënë më të kjartë leximin e raportit për qytetarët e komunës së Malishevës.

Kryetar tani nuk jam duke folur si anëtarë i Kuvendit as si anëtarë i partisë NISMA por si qytetarë i Komunës së Malishevës.Unë ndihem komodë tejet i përfaqësuarë prej juve si Kryetar i Komunës dhe mendojë që të njejtën ndjesi e kam shumica e qytetarëve të Komunës së Malishevës,madje kjo punë e jashtëzakonshme është kuroruarë me një rezultat të jashtëzakonshëm,ju inkurajojë me vazhduarë në këtë formë neve do të na keni mbrapa.Faleminderit.

Vlera Bytyçi(anëtare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Përshëndetje për të gjithë!Sa i përket raportit të punës së Kryetarit unë me të vërtetë kisha dashur me analizuarë një raportë të mirëfilltë e jo vetëm një raportë copy paste(të kopjuarë) nga viti 2022 në vitin 2023,kjo tregonë më së miri për punën në faktë për mos punën kur raportet e vitit 2022 barten në vitin 2026 nuk e di qfarë me analizuarë më shumë.Faleminderit.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesues.Unë e kam parë raportin i cili më ka ardhur në email adresë,e kam lexuar tek pjesa ku ceken drejtoritë përkatëse dhe aty kompletë e kam vërejturë që nuk është ndonjë gabim teknik por në secilën faqe është kompeltë e njejtë që nga viti 2022 dhe 2023 gjë që nuk mundesh me bërë as krahasime,unë nuk e di stafi i Kryetarit a është marrë seriozishtë me këtë punë sepse është duke na ardhur një dokument zyrtar me të cilën ju dërgohet të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

E marim shembull tek kategoria e shpenzimeve,raportë i punës së Kryetarit dhe të drejtorive të komunës së Malishevës për periudhën janar 2025-të është tabela kompeltë e njejtë me të dhënat siq kanë qenë në vitin 2022 dhe 2023 dhe do të ishte mirë që Kryetari para se me prezantuarë raportin për 2024,2025 dhe 2026 është mirë me u marrë stafi i tij shumë seriozishtë me këtë raportë,sepse këtu nuk duhet me llogaritur vetëm një faqe gabim por i keni secilën faqe gabim.

Këtë raport e kemi secili prej neve në email adresë dhe ne me qenë të pa ndershëm po e them në thonjëza mundemi me publikuarë se qfarë jemi duke raportuarë në vitin 2026 raportin e vitit 2022 dhe 2023,Kryetari duhet me u marrë seriozishtë me stafin e tij,ndonjërin duhet me dërguar te shtëpia për këtë gabim teknik,ky nuk është gabim teknik ose është i qëllimshëm që e sabotonë punën tënde ose është total i pa dijshëm në nivelin më të mundshëm.

Nuk janë duke e kontrolluarë një dokumentë kaq të rëndësishëm para se me u bërë dokumentë zyrtarë i protokoluarë dhe me ju shpërnadrë anëtarëve të Kuvendit.Unë nuk dëshirojë me diskutuarë asnjërën prej temave.

Kjo është një shkëlje prej vetë stafit.Unë me qenë në pozitën e Kryetarit isha marrë seriozishtë me njerëzit që i ka në kabinetë të cilët kujdesen për punën e tij dhe për dokumentacionin që e sjellin.Faleminderit shumë.

Demir Bajra(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë fillimishtë Kryetar ju përgëzojë për shëndetin që keni bërë më mirë sepse kam ndëgjuar se keni pasur problem me shëndetin dhe me kënaqësin më të madhe po ju them.

E përcjella me vëmendje raportin për vite me rradhazi që e laboruatë më dha kurajo fjalimi i z.Halilit që tha nëse nuk gabojë për mbi dy qindë mijë vizita janë ofruarë në shërbime mjekësore por në qfarë kohe?

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Janë ofruarë dy qindë e gjashtë dhjetë mijë shërbime shëndetësore në vitin 2025-të.

Demir Bajra(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Pyetja ime për ju Kryetarë është sa keni arritur gjerë më tani me përfunduarë kontratën kolektive?Këtë pyetje e kam parashtruaë kur keni qenë në fshatin Panorç.Mua më interesonë shumë por edhe opinionit të dimë së paku sepse unë i takojë pjesës që kam punuarë në arsim,ka pesë mujë që nuk jemi në procesë por më interesonë sepse unë e di sa kanë marrur prej kontratës kolektive por dëshirojë me ditur ku jemi.Faleminderit.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesus.Përshëndetje për të gjithë.Ajo qfarë dëshirojë me thënë në lidhje me këtë raportë janë kritika,por herën tjetër raportet e tjera të na vijnë në mënyrë të përpiluara mirë që tregojnë

profesionalizëm sepse ky dokumentë është i rëndësishëm për të gjithë. Dokumentet zyrtare tregojnë profesionalizëm dhe jo të jenë të dobëta në cilësi.

Ju jeni përqëndruarë që të ketë volumë sa më shumë, janë disa gjëra që janë obligime ditore dhe nuk mundeni me i futur në cilësinë e arritjes për shembullë ishte përmendur shumë mbajtja e takimeve, formimi i komisioneve, inspektimet që janë bërë gjatë vitit, këto për mendimin tim nuk i përkasin një raporti të Kryetarit siq është raporti një vjeçarë i punës së Kryetarit.

Pastaj e keni një përshkrim të aktiviteteve shumë të madha, tek pjesa që fletë për probleme do me thënë janë probleme që përmenden vetëm sipërfaqësishtë, nëse janë këto probleme që i ka komuna jonë është mirë me folur për këto, me qenë edhe qytetarët në dijeni dhe jo vetëm se e kemi këtë problem por me ditur a pritet me u zgjedhur apo qfarë do të bëhet më tutje?

Ajo qfarë dëshirojë me përmendur që më ka rënë në sy më së shumti është tek pjesa e shëndetësisë përmenden investimet dhe që është shtruar asfalti kurse më poshtë e gjeni që raporti bie në kundërshtim me vetëm në këtë rastë e gjeni që problemë kryesorë në QKMF mbetet mungesa e stafit dhe po ashtu furnizimi jo i mjaftueshëm me barna, pastaj një pjesë tjetër që për mendimin tim kur e thashë që ishit fokusuarë shumë te volumi që të jetë një raportë sa më i gjatë e vërejtja që disa fjali nuk janë adekuate për një raportë zyrtarë për shembullë fjalia mbështetje dhe inkurajim për secilin që ka paqartësi në detyrat e tyre.

Qfarë i duhet qytetarit kjo nëse ju e keni inkurajuarë një punëtorë apo zyrtarë se si duhet me punuarë? Faleminderit.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit edhe njëherë Kryesues. Një pjesë që e tha Vetoni unë mundem me u pajtuarë sepse ka mundur me u përpiluarë raporti shumë më mirë. Ky raportë mundet mos me qenë i mirëfilltë këtu pajtohem edhe me znj. Vlerën mirëpo ju lëreni raportin. Dilni jashtë dhe shikoni punën sepse ajo është punë e mirëfilltë pa raportë. Projekti i cili është i mirëfilltë e për mua kjo ka rëndësi, raporti edhe nëse nuk është i mirëfilltë punë e madhe.

Ne jemi organizatë buxhetore që i kemi pasur përafërsishtë nga pesë milionë euro në vitë buxhetë për investime kapitale për katër vite bëjnë njëzetë milion euro.

Qeveria e Republikës së Kosovës është organizatë buxhetore me kornizë vjetore që për investime kapitale i ka afërsishtë një miliardë euro në vitë e për katër vite bëjnë katër miliardë euro. Por gjejeni një lloj projekti që për katër vite e ka bërë qeveria e punës me qenëse kjo është pjesë e punës apo mos punës tonë, gjejeni një që e kap vlerën e saj dhe unë ta zgjati dorën ty, por nëse ne do ti kishim katër miliardë euro e tërë Kosovën e kishe parë të mirëfilltë kështu po fatëkeqësishtë ne nuk i kemi dhe nuk kemi qfarë të bëjmë.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Përshëndetje! Unë e kam një vërejtje për shërbimin tuaj administrativ, në emailin e adresës time më ka ardhur vetëm rendi i ditës prej kolegut tim asambleistë z. Skender Zogaj, mua nuk më kanë ardhur fare materialet e tjera që jemi duke diskutuarë për këtë rendë të ditës sot, se si ka ardhur deri këtu kështu nuk e di. Unë nuk e di se cili ka qenë qëllimi por uroj që të jetë i gabueshëm sepse raporti i punës së Kryetarit është një dokumentë i rëndësishëm.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftesa është dërguar më 13 Maj që është e specifikuarë nga kush është dërguarë pra nga zyrtarja znj.Argenita Thaçi në email është e kuartë që është përfshirë edhe email adresa juaj z.Enver Hoti por tek z.Skender Zogaj është një email që është e përsëritu që është dërguarë por besojë që nëse e shikoni në email më poshtë i gjeni materialet e bashkangjitur.Faleminderit.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përsëndetje Kryetar,Kryesues,kolegë.Me folur për një raportë kaq voluminozë nuk ka nevojë sepse Kryetari ka shkruarë shumë aty nuk është dashur me i shkruarë të gjitha ato gjëra.Vetëm me dalur me shetitur dhe me i parë pamjet e sheshit dhe të bulevardit mjaftonë.Tani kanë filluarë fushatat dhe unë e kam parë njërin prej kandidatëve që nuk është nga Malisheva por është duke e reklamuarë sheshin dhe bulevardin do me thënë kjo i përgjigjet pytjes së znj.Valjetës që tha për me inkurajuarë.Eman Rahmani kandidati për deputet e reklamonë punën e Kryetarit z.Ekrem Kastrati kështu është modeli edhe unë pajtohem që ka gabimet teknike.

Unë kam qenë pjesë e punëve të Kryetarit nuk ka qenë punë e lehtë,unë kam qenë në periudhën më të vështirë që e ka pasur.Gjejeni ju një komunë të nderuar Asambleistë që në mënyrë masive e ka bërë lirimimin e hapësirave publike,,jo vetëm që ka qenë detyrë e jona ne nuk jemi duke e kontestuarë atë,ne si Drejtori e Inspektoriatit në atë kohë kemi ekzekutuarë mbi një qindë e katër dhjetë vendime të Drejtorisë së Gjeodezisë të kolegut z.Bashkim Krasniqi i cili i ka identifikuarë dhe rregulluarë.

Ne jo vetëm që e kemi bërë lirimimin por nuk e kemi pasur asnjë eksese më të vogël kjo është fatëbardhsia,kjo është ajo inkurajimi ejani merreni model komunën e Malishevës.Zgjedhjet e fundit e treguanë rezultatin.Unë kam qenë Drejtorë i Inspektoriatit kam rënuar kam denuarë por kur kam kandiduarë për Asamble e kam dy fishin e votave të juaj sepse e ka vlerësuar qytetari.

Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati ka mundur fare mos me shkruarë në letër qytetari e ka vlerësuar punën e tij.Ne nuk po themi që nuk ka gabime sepse ka gabime.A i kemi rrugët e prishura në bashkësi lokale?Po i kemi.Mirëpo aty është duke u punuarë,Kryetari i shpejgojë të gjitha.Kontrata kolektive nuk është problemë vetëm i Komunës së Malishevës por është e nivelit qëndrorë pra edhe të komunave të tjera.Të gjitha ato kontrata që janë bërë në fushata politike shkelë e shko për vjedhje votash tani koson me paguarë komuna i kanë rënë në barë Kryetarit z.Ekrem Kastratit për me u përballuarë por edhe ju ka rënë në barë edhe komunave të tjera.

Unë mendojë që është bërë një punë e mirë,unë jam pjesë e pozitës dhe i pranojna kritikën kur diqka ka keq dhe është në dobi të qytetarit nuk më vjenë keq me dalur në foltore dhe me u pajtuarë me të.

Kryetar z.Ekrem Kastrati me këtë ecuri të punës që e keni ju urojë shëndetë dhe neve do të na kesh mbrapa dhe jo vetëm deri në vitin 2029-të por derisa të mërziteni ju vetë do të jeni Kryetar i Komunës.Faleminderit.

Vlera Bytyçi(anëtare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Ne jemi duke diskutuarë për një raportë të punës një vjeqare të Kryetarit të Komunës,e që ju Kryetar jeni duke folur për një

projektë katër vjeçarë që gjatë mandati katër vjeçarë e keni pasur vetëm një projektë Malisheva Urbane.Faleminderit.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Një ndërlidhje të shpejtë atë qfarë e tha kolegu z.Hafir Rexha,e para unë nuk besojë që këtë raportë e ka lexurë ndonjë kolegë i juaj i përbashkët,tjetra unë e thashë që obligimet ditore bisedat miqësore që bëhenë në mes të drejtorit dhe stafit të tij nuk i përkasin një dokumenti të tillë,në këtë formë e thashë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ju faleminderit.A ka ende dikushë nga anëtarët e Kuvendit për të diskutuarë raportin e Kryetarit për vitin 2025-të?Atëherë vazhdojna me pikën tjetër të rradhësFjalën ja kalojë Drejtorit për ekonomi dhe financa z.Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi(Drejtor për ekonomi dhe financa):Përshëndetje të nderuar Asambleistë,i nderuar Kryetar.Ju e dini që ne si udhëheqje e drejtorisë komunale raportojmë gjdo tre muaj pra do me thënë i kemi katër periudha financiare për të cilën bëjmë raporte financiare të pasqyrave të hyrave dhe shpenzimeve,në të njejtën kohë e bëjmë edhe raportin e Kryetarit me të cilën e bëjmë publike gjdo tre muajë me të cilën publikohet në faqen publike të komunës gjithashtu e kemi për obligim me paraqitur raportin një vjeçarë të punës së Kryetarit.

Ne i kemi 13 Drejtori është e natyrshme me pasur edhe gabime teknike raporti që u prezantua nga Kryetari.Në raportin për vitin 2025 paraqiten për secilën sektorë të dhëna për punën e kryer për vitin 2021 për të cilën ndoshta mundë të themi kronologjia e renditjes së raportit mundë të përsëritet mirëpo vlera dhe shuma nuk është e njejtë.Pra ka gabime teknike nga ana e zyrtarëve por jo tek paraqitja e raportit sepse unë e thashë që ne katër herë brenda vitit paraqesum pasqyra financiare si dhe planin e punës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Fjalën e ka kërkuarë Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani.

Amrush Helshani(Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastrati,i nderuar Kryesus dhe ju të gjithë kolegë Asambleistë të pranishëm.Për mos me i mbetur në borgj z.Veton Zogaj dhe disa të tjerëve që ngritën pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.Kushtet sanitare në Qendrën e Mjeksisë Familjare janë në nivelin e duhur dhe i përmbushin standardet e kërkuara megjithatë për shkakë të fluksit të madh të pacientëve në raste të caktuara mundë të ketë hapsirë për përmirësim për të cilën jemi më tej të angazhuarë.

Unë i nderuar kolegë Asambleistë ju sygjerojë ato fotografi që ju i keni,dërgomi në emailin tim sepse unë jam i gatshëm me bashkëpunuarë me juve dhe secilin Asambleistë,ju lutem përcjellni në email dhe ne do ti trajtojmë seriozishtë.

Sa i përket etheve hemoragjike disa ditë më parë ka filluar dizensektimin në disa zona endemike të komunës së Malishevës,kjo si masë parandaluese kundër etheve hemoragjike.

Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati ka themeluarë shtabin komunal për menagjimin e etheve hemoragjike dhe aktualishtë i kemi mbi 230 raste së pickimit me riqna,fatëmirësishtë nuk kemi asnjë rastë të infektuarë.

Sa i përket qështjes së procedurave sipas strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemoragjike dizensektimin e bënë Agjensia e Ushqimit dhe Veterinës,janë ekspertët e fushës ata që e vlerësojnë se kur duhet të fillojë kjo fushtë e dizensektimit.

Ndërsa sa i përket shërbimeve të ofruara në vitin 2025-të sigurishtë qëndronë ajo që është e shenuarë në raportë sepse ashtu e kam pranuarë edhe unë.

Dëshirojë me ju informuarë se në të gjitha institucionet e shëndetësisë gjatë kësaj periudhe tre mujore janë ofruarë mbi 84,896.00 shërbime duke e përfshirë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe të gjitha qendrat e mjekësisë familjare dhe Ambulancat që operojnë në Komunën e Malishevës.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Meqenëse ka përfunduarë debati unë edhe njëherë e falenderojë Kryetarin e Komunës z.Ekrem Kastrati për prezentimin e raportit të punës për vitin 2025-të.Kalojmë në pikën e katër të rendit të ditës.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në bujqësi në Komunën e Malishevës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë Drejtorit për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukolli.

Sylë Dukolli(Drejtor për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural):Faleminderit Kryesus.

Përsëndetje i nderuar Kryetar,të nderuar kolegë Drejtor,të nderuar anëtarë të Kuvendit.Sot do të paraqesë një dokumentë para juve për dëmet që janë shkaktuarë më datën 5,6 dhe 7 në muajin Prill të vitit 2025-të të cilën e kam paraqitur në KPF e që deri më tani nuk është proceduarë mirëpo më mirë vonë se kurrë.Unë i kam raportet nga Agjensioni i cili bënë vlerësimin për kompenzimin e dëmeve i kam tri raporte e që bujqit tanë ende nuk i kanë marrë mjetet që janë vlerësuarë për kompenzimin e dëmeve nga komisionet e tyre edhe na ju.

Prandaj po ju drejtohem bujqëve që është hera e tretë që unë bëjë raportin për kompenzimin e dëmeve sidomos për pemëtarët që ju ka shkaktuarë dëme nga bora dhe ngritëzat më datën 5,6 dhe 7 Prill në vitin 2025-të ku në raportë janë të përfshirë 20 pemëtarë që kanë mbjellur kryesishtë mollë,kumbullë dhe dardhë dhe shumë të tjera që fermerët tanë jamë dëmtuarë dhe vlera kompeltë e tyre shkonë 542,926.00 duke e llogaritur që vitin e kaluarë vetëm pak ndonjë mollë ka qenë dhe as edhe ndonjë frutë në Komunën e Malishevës nuk ka pasur mundësi që të zhvillohet për shkakë të kushteve natyrore nga bora dhe ngritëzat.

Unë për mos me ju marrë shumë kohë të gjitha procesverbalet janë respektuarë,unë nuk jam zyrtar që pa e kompletuarë raportin e sjelli këtu te ju,unë kam shkuarë sipas udhëzimeve të Ministrisë dhe duke e falenderuar komisionin e falenderojë edhe një personë të veqantë zyrtaren znj.Blerina Hoti e cila e ka sjellur kompeltë modelin e Ministrisë së Bujqësisë dhe ne e kemi pasur më të lehtë për me nxjerur përqindjen e dëmeve që u janë shkaktuarë fermerëve tanë.

Unë nuk dëshirojë me zgatur më tutje vetëm kërkojë votën e juaj që të paktën fermerët mos të dëmtohen nga ATK-ja sepse edhe nëse nuk kompenzohen nga Ministria e Bujqësisë, fermerët tanë po dëmtohen nga ATK-ja në emër të asaj që nëse nuk kanë dëshmi që kanë pasur dëm që është vlerësuarë ata e kërkojnë përqindjen e tyre, ata e kërkojnë një përqindje kinse e kanë shitur ndonjë kilogramë në pikat grumbulluese.

Raportin e kam të kompletuarë dhe nuk kam mundur me ju sjellur përsecilin fermerë. Fillimisht janë bërë kërkesat për dëmet që janë shkaktuarë në bujqësi me të cilën është formuarë komisioni dhe kanë dalurë në terren kanë bërë fotografimin, pastaj është bërë përpilimi i raportit me të cilën kanë nënshkruarë fermerët e ka nënshkruarë edhe komisioni për vlerësimin e dëmeve pastaj ky raportë ka ardhur tek unë dhe e kam dërguarë në formë të përmbledhur te Kryetari i Komunës i cili e ka nënshkruarë pastaj e kam paraqitur në KPF dhe sot e kam sjellur tek ju për miratim të përgjithshëm në Kuvend. Faleminderit për gjdo pa kjarhtësi eventuale jam këtu.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit Drejtor. E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuarë z. Hafir Rexha.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Drejtor për raportin e detajuarë edhe unë e përgëzojë stafin e juaj që kanë përvojë shumë të mirë dhe besojë që ky raport do të miratohet nga ne do të dëgjohet edhe në Ministrinë përkatëse sepse me të vërtetë ata fermerë kanë bërë mundim dhe meqenëse ne si Komunë nuk kemi buxhet të veçantë për me ju ndihmuarë sepse do të ishte mirë që edhe ne si Komunë të gjejmë mënyra dhe është vetëm kjo linjë përmes Ministrisë përkatëse, kërkojë që ju Drejtor të jeni aktiv shumë ashtu siq keni qenë deri më tani për realizmin e kërkesave të fermerëve. Ju falenderojë për raportin dhe ju mbështesë.

Veton Zoga (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Faleminderit Drejtor. Ne e kemi diskutuarë edhe në KPF këtë qështje e kam vërejtur që në listën i keni bashkangjitur te raporti 20 emra. Dëshirojë me ditur a ka pasur kërkesa më shumë se sa këta që i kanë paraqitur? Gjatë inspektimit komisioni përkatës i cili e ka bërë vlerësimin a ka pasur edhe raste të tjera të cilët kanë hezituarë me bërë kërkesë apo nuk janë përfshirë fare?

A janë paraqitur vetëm 20 kërkesa, a ka kërkesa që janë refuzuarë sepse kanë tentuarë me keqpërdorë pra nuk kanë pasur dëmtime? Unë mendojë që është një hap i mirë prej anës së juaj që e keni bërë një përmbledhje të këtij raporti, mbetet vetëm me parë më tutje se si do të përgjigjet Ministria e Bujqësisë. Dëshirojë me ditur a ka pasur edhe emra të tjerë që e kanë aplikuarë pra që e kanë paraqitur kërkesën?

Burim Paqarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Përshëndetje edhe njëherë. Unë e analizova raportin që e paraqiti Drejtori për Bujqësi dhe Pylltari e falenderojë për raportin e vlerësojë shumë i cili është i specifikuarë me emrat e të gjithë fermerëve të cilët kanë aplikuarë. Unë i bashkangjitna pyetjes së z. Veton Zogaj. A ka pasur edhe fermerë të tjerë që kanë pësuar dëme nga ato vëshime?

Si raportë më pëlqenë sepse jam duke e vërejtur që janë caktuarë vlerat e dëmit për secilin fermerë, në momenti që ata janë brenda listës besojë që ata janë pajtuarë me vlerësimin të cilën edhe e kanë nënshkruarë që nënkuptonë se janë pajtuarë.

Të dhënat vërehenë që janë të gjitha uroj që secili që ka pësuar dëme nga fatëkeqësitë natyrore të ju bëhet kompenzimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, besoj që me presionin dhe shtytjen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe të Kryetarit dhe kujt do qoftë tjetër që ka mundësi me pasur ndikim te kjo linjë e Ministrisë ti gëzojnë fermerët me të holla duke ju kompenzuarë dëmin. Besojë që në të ardhmen do të ju kishte ndihmuarë shumë për kultivimin e produkteve të tyre sa më cilësore. Faleminderit shumë.

Fitim Shala (anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës): Unë e përgëzojë stafin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Drejtorit për raportin që e ka punuarë për dëmin që ju ka shkaktuarë fermerëve tanë.

Unë uroj dhe shpresojë që ky raport dhe kjo votë e jona sot në Asamble, fermerëve të mos ju shërbejë vetëm si dëshmi te Inspektoriatit Tatimor por ta marrë mbështetjen e plotë nga niveli qëndrorë.

E përsërisë edhe atë që e kam thënë te raporti i dëmeve për ekonomi familjare që e keni sjellur nga seancat e kaluara jam shumë skeptikë për ndihmën që do ta marrin nga niveli qëndrorë. Faleminderit.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Dëshirojë me ja parashtruarë vetëm një pyetje një plotësim te emërtimi i Drejtorisë.

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me sa e di unë i nderuar drejtorë, tani pyllaria është në kuadër të agjensionit do të ishte mirë me ndryshuar pasi që nuk keni përgjegjësi sepse e ka marrë agjensionin do të ishte mirë me bërë përmirësimin në emërtimin e drejtorisë. Ndoshta mundem me gabuarë mirëpo sqarimin do të na jep drejtori. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Kur të ndryshohet statusi i Asamblesë Komuale ndryshohet edhe emërtimi i drejtorisë. Fjalën ja kalojë drejtorit për përgjigje.

Sylë Dukolli (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural): Ministria i ka disa kushte për fermerët që me përfituarë subvencione duhet me qenë të rregjistruarë. Nëse ndonjë fermerë ka mbjellur shtatë ose tetë dhjetë ari, një hektarë dhe ende nuk e ka rregjistruarë nuk e kanë rregjistruarë biznesin e vetë bujqësorë ne nuk mundemi me i ndihmuarë sepse janë disa kode të cilën e përcaktojnë se cilat janë në hartën e bujqësisë.

Ne jemi takuarë me të gjithë fermerët i kemi pritur dhe ju kemi treguarë që është 100% vlerësimi i atyre parcellave që kanë investuarë edhe pse ajo nuk ka qenë frutë ajo e ka pasur trupin dhe kemi shkuarë me përqindjen më të ulët dhe e kanë nënshkruarë vetë.

Ka pasur kërkesa që nuk ju ka takuarë me bërë sepse ndryshe janë kërkesat që kanë qindra hektarë pa dashur me injoruarë ndonjërin.

Sa i përket pyetjes së z. Hafir Rexha ne e kemi pyetur Ministrinë a mundemi me hjekur këtë emërtim ata na kanë thënë se edhe Ministria po quhet ashtu, kur ne e ndryshojmë emrin e ndryshoni edhe ju. Unë gjdo herë drejtohem vetëm si Drejtorë i Bujqësisë.

Ne vetëm një herë deri tani i kemi marrë gjashtë, shtatë apo një qindë mijë euro saktë nuk më kujtohet që e ka bërë kërkesën komuna para disa viteve.

Unë i kam dërguarë edhe dy raporte që i kam dorëzuarë dhe ende nuk i kanë kompenzuarë mjetet.

Kërkojë nga Ministria e Bujqësisë nga këtu i bëjë thirrje që ti kompenzonë fermerët sepse me të vërtetë është problemë me investuarë një zetë mijë euro në vitë në mirëmbajtje në krasitje, në herbecide dhe të gjitha aty dhe mos me marrë asnjë kompenzim për mua kjo është e pa logjikshme.

Sa i përketë vërshimeve që kanë ndodhur unë nuk kam qenë pjesë e komisionit aty ka qenë një anëtarë i bujqësis për dëmet në bujqësi edhe unë jam i të njejtit mendim për atë që e thatë ju z.Ftim sepse edhe unë jam i ndrojtur dhe skeptik për kompenzimin e dëmeve që do ti bëjnë edhe pse menjëherë pas vërshimeve na kanë premtuarë komepznim për dëmin e shkaktuarë. Kërojë që të ketë mbështetje për fermerët që adresohenë në sektorin e bujqësisë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor meqenëse debati është shtjerur e hedhi në votim.Kush është për?

Rezulati i votimit:20 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se raporti për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësishtë natyrore elementare në Komunën e Malishevës u miratua unanimishtë nga Kuvendi i Komunës.

Pika 5

Pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. nr 04/254, datë 04.05.2026, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin fiskal 2026.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë Drejtorit për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesus.Para juve kemi prezentuarë si gjdo vitë kërkesën për bartjen e të hyrave për vitin paraprakë edhe në këtë vitë është faktë që kemi tejkalim i të hyrave 1,104,460.98€ urojmë që prapë me pasur rritje tek të hyrat për me pasur mundësi me i kryer të gjitha ato obligime kontraktuale dhe të gjitha obligimet e tjera që i kemi në projektë buxhetë.

Kam dalur këtu para juve me prezentuarë një ndryshim,ju para se me ardhur në mbledhje e keni pasur një kërkesë që ndryshonë për dy shuma dhe e kemi plotësuarë sot dhe arsyetimin po e jap sot sepse tek projektë renovimi i lokaleve ka qenë 250,000.00€ para se me ardhur këtu kurse tani është 170,000.00€ arsyeja është sepse është realizuarë shpenzimi i mjeteve në këtë projektë dhe obligimi ndaj këtij projektë janë vetëm 170,000.00€ dhe e kemi bartur tek kodi (570002) i kemi shtuarë 30,000.000€ me arsyetimin dhe nevojën e kërkesës për administratën për automjetet e komunës këtë kod e kemi paraqitur dhe kemi prezantuarë mjete prej 30,000.00€.

Gjithashtu pjesa prej 50,000.00€ është tek kontrata e cila është e pa përfunduar te rrugët nëpër fshatra që është në kodin (53427) do me thënë është vetëm ky ndryshim për arsyeje e tregova që për pjesën për të cilën është planifikuarë për bartjen e mjeteve nga viti 2025-të te renovimi i rrugëve është kryer si obligim shuma prej 80,000.00€ dhe për këtë arsyeje kemi kërkuarë që kjo shumë të bartet te pjesët e tjera të kodeve.

Një përgjigje do të ja jap për z.Burim Paqarizi i cili e parashtrijë para rendit të ditës se a kemi arsyeje të barten disa kode mirëpo te qështja e renovimit të rrugëve nuk ka mundësi të vendosen sepse është projekt i ri i cili do të fillojë procedurën kemi planifikuarë për renovimin e rrugëve,shumën egzistuese që e kemi në vlerën prej 170,000.00€ nuk kemi mundësi me shtuarë më tepër dhe një kërkesë tjetër ishte te kanlizimet dhe ndriqimi publikë.

Te ndriqimi publikë i kemi mjetet dhe ajo është aktive dhe ajo mundë të realizohet dhe kjo nëvaret vetëm prej operatorit.Te kanlizimet janë në përfundim të kontratës dhe për këtë arsyeje janë planifikuarë kanlizimet e reja dhe janë në procedurë e sipër.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Hapi diskutimin për këtë pikë.

Veton Zoga(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit,unë shumë qështje i diskutoj në KPF mirëpo për hirë të opinionit publik do të flasë edhe këtu.Komuna ka inkasuarë dhe janë rritur të hyrat gjdo vitë,mirëpo shpërndarjen apo bartjen kur po e bëjmë te kategoritë e caktuara po ka koncentrim në projekte të caktuara të cilat po e marrin shumicën e mjeteve të buxhetit dhe shumë fshatra po mbesin pa u investuarë shuma prej 1,104,460,98€ për bartje ajo qfarë ka ndryshuarë siq e tha edhe Drejtori në mbledhjen e KPF-së nëse nuk gabojë ka qenë si kod shuma prej pesë apo dhjetë mijë euro për pajisjet me vetura zyrtare sot në kërkesën që ka ardhur është shuma prej 40,000.00€.

A është duke u bërë fjalë për një veturë zyrtare që ka me u blerë apo për disa?Unë nuk e kam të kuartë.

Pastaj për mua është problemë shuma shumë e madhe te bartja që kërkohet në kodin(51787) për rregullimin e sheshit është kërkuarë mbi gjysmë milionë euro me shkuarë kompletë gjysma e të hyrave vetanake në projektin e njejtë.

Qështje tjetër është kodi (53427) janë planifikimi mjedisor dhe inspeksion do me thënë asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra janë mbi dhjetë fshatra ndërsa shuma është shumë e vogël vetëm 50,000.00€.

A është si shtesë për shumat e tjera që i ndanë projekt buxheti sepse promblet nëpër fshatra janë shumë më të mëdha unë nuk besojë që munden me u mbuluarë një fshatë e lërë më dhjetë prej tyre.

Qështja tjetër është edhe te rregullimi i kolektorit të ujërave të zeza faza I Bubël-Lumishtë 2.5 km janë të parashikuarë vetëm 30,000.00€ për këtë projektë jeni edhe ju i informuarë prej që kam qenë Asambleistë gjdo vitë në projektë buxhet ndajmë shumë të konsiderueshme të mjeteve dhe unë nuk jam duke parë asnjëherë që janë duke bërë investime.

A është duke lëvizur si kod apo thjeshtë është shkruarë vetëm në listë 30,000.00€?Faleminderit.

Burim Paqarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë e analizova me kolegët raportin është mirë që të hyrat vetanake po rriten në vazhdimësi,ndërsa te qështje e planifikimit dhe bartjes ne vazhimishtë i kemi dhënë vërejtet e tona për disa projekte të cilat po ridestinohet mjete prapë dhe projektet nuk po përfundohen.

Unë e kam një propozim që këto mjete të barten edhe në një rrugë në fshatin Dragobil që është një gjatësi e vogël e asfaltimi i rrugës së "Korizit" në fshatin Dragobil dhe vazhdimi i rrugës "Ali Paqarizi" me gjatësi 700 metra si total,ndërsa tek kjo rruga e "Korizit" të bëhet edhe vendosja e kanalizimit në gjatësi prej 200 metra,besoj që nuk është vlerë e madhe dhe si vlerë totale e të

hyrave vetanake në vlerën prej mbi një milionë euro atëherë besoj që nga këto mjete kemi mundësi me bërë këtë propozim edhe është një vërejtje në vazhdimësi nga banorët e fshatit Dragobil, janë disa shtëpi aty që nuk kanë fare qasje në kanalizim dhe do të ishte mirë në cilën do formë me bërë zgjidhje nëse kemi mundësi nga të hyrat vetanake me kryerë këtë procesë, besojë që do të ju kishim lehtësuarë jetesën atyre sepse ata ende kanë probleme në rrugë me gropa septike, janë për mbi 15 shtëpi të reja që janë ndërtuarë që nuk e kanë rrugën e asfaltuarë e kanë rrugën me zhavorë dhe në momentin që ka rreshje atmosferike aty prishet rruga në vazhdimësi.

Unë e kam shkrurë këtë propozim në formë të jeshhtë me lapskimik me të cilën besoj që Kryesusi mundet me hedhur në votim. Faleminderit.

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma): Faleminderit Kryesus, mendoj që është një arritje e mirë rritja e të hyrave vetanake dhe natyrishtë është një vlerësim i mirë se si kemi me i kthyer këto mjete të tatim paguesëve të Malishevës.

Unë Drejtor kisha dashur me na shpjeguarë këto a janë borgje apo projekte të reja? A do të përmbyllenë disa borgje që mos të ketë probleme të mëtutjeshme?

Ne a do të kemi mundësi me propozuarë diçka të re?

Nëse disa janë projekte të reja dhe i shtohenë projektë buxhetit aktualë atëherë do të ishte mirë edhe të tjerëve me ju dhënë rast me propozuarë sepse kërkesat janë të mëdhaja gjithë andej.

A do të përmbillet borgji në shesh me këtë shumën e lartëcekur?

Renovimi i rrugëve a është bërë apo ka me filluarë si projektë?

A mundenë me u asfaltuarë të gjitha ato rrugë me shumën që është cekurë në vlerën prej 50,000,00€ apo ka vlerë tjetër që i shtohet? Do të ishte mirë me qenë të shpjeguara në letër por të paktën na shpejgo këtu në mënyrë të drejtë për drejtë.

Te pjesa e kolektorit me të cilën do të vendoset ne 2.5 km, unë nuk besojë që do të kenë mundësi me u përfundurë.

Këto shifra me na shpjeguarë a janë shtesë e asaj që ka me u realizuarë apo janë borgje që duhet me u përmbyllurë?

Nëse herën tjetër kemi për shembullë të hyra vetanake para praktikishtë këtu në Asamble me ditur se a do të shpërndahen apo jo, për qfarë janë duke u ndarë sepse edhe ne që jemi duke e dhënë votën me ditur qëllimin. Faleminderit.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Te planifikimi mjedisor dhe inspeksioni kemi një numër të madhë të fshatrave me të cilën e përmendi edhe kolegu z. Bashkim Krasniqi shuma e vlerës është përfshirë prej 50,000.00€ sigurishtë që këtij kodi duhet me ja shtuarë këto mjete sepse përndryshe nuk ka sensë.

Me sa di unë projektet të cilat nuk janë në projekt buxhet nuk munden me i futur në kuadër të hyrave vetanake pra projekte të reja, nga përvoja e mandatit të kaluarë kur ka ndodhur që kemi futur projekte të reja na kanë kthyer Ministria e Pushtetit Lokal me arsyetimin se nuk keni të drejtë me bërë këtë punë sepse keni ende projekte të pa realizuara, e ne duke e parë gjendjen me të cilën jemi për shkakë të përmbaruesit ne edhe me këto mjete por edhe me ju shtuarë nuk do të kemi mundësi me i përfunduarë ato punë të cilat i kemi parashikuarë me projekt buxhetë, kështu që këtë shpjegim e deshta edhe pse mendojë që nuk ka mundësi me u përfunduarë. Faleminderit.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus është një fakt i mirë që janë rritur të hyrat vetanake mirëpo kur vie qështja tek shpërndarja e tyre do të ishte mirë me pasur një angazhim më të mirë.Në bazë të asaj që vërehet në buxhetin e miraturë për këtë vitë kemi folur për sheshin ndërsa me shumën të cilën e keni parashikuarë këtu mbi 552,290.00€ kurse vlera e këtij investimi ka kapur shumën mbi 2 milion euro duhet me na jepur një arsyeje.Kur do të përfundojë ky projektë?Sepse ju jeni pjesë e qeverisjes komunale duhet me na jepur një arsyetim më të madhë.

Ndërsa për projektet e tjera që janë të përfshiera këtu,aty vërehen më shumë si mbështetje,uroj që ato projekte që lidhen me investime të infrastrukturë,me kanalizime mendoj që janë në zhvillim do të ndikojnë në të mirë.

Unë do të kisha dashur që këto të hyra vetanake të jenë të përcaktuara në fusha të tilla sepse këto të hyra e kanë një bazë nga këto ndërtime që janë duke ndodhur në komunë nga investimet ndërtimet e larta që keni krijuarë banime të reja,të hyrat ju keni marrë investitorëve dhe gjendja do të ju kthehetë atyre pra përmes këtyre të hyrave ju do ti ktheni disa shërbime për ata,ju e dini kush ka investuarë,subjektet afariste por disa nuk kanë energji elektrike,furnizim dhe ujë as infrastrukturë nuk i kanë shërbimet elementare ju i keni marrë ato para nga qytetarët pra blerësit nga investimet dhe pastaj me i dërguarë ju ku të dëshironi,si te keni vullnetin ju dhe kjo nuk është e adresuarë kjartë.Shkoni vizitoni banorët pyeteni se në qfarë gjendje janë duke jetuarë nuk ka planë urbanistikë,nuk ka harta zonale e shumë të tjera që ne i kemi diskutuarë këtu.

Tani do të flasë për gjendjen e arsimit ju e dini si e keni gjendjen në shkolla duke filluarë nga infrastruktura bazike nga këto të hyra të takasa paguesëve të Malishevës,ndërsa fëmijët tanë mësimdhënësit tanë nuk i kanë kushtet me zhvilluarë procesin mësimorë së asnjë aspektë duke filluar me mungesën e ngrojes,probleme higjenike pa pastërtisë nuk jam duke folur për paisjet e konkretizimit që duhet me u avancuarë dhe me ju lehtësuar punën mësimdhënësve dhe nxënësve.

Këto të hyrat janë nga qytetarët tanë në gjdo lloj takse që e kemi grumbulluarë unë uroj që këto të hyra të rriten akoma më shumë por këto të hyra të adresohenë dhe të kthehenë direk te qytetarët. Mendoj që komuna ka pasur buxhet për me rregulluarë disa qështje.Kërkojë falje por keni marrur një pasqyrim të keq përngjani sikur keni krijuarë një lloj komunikimi me biznet për me ju rregulluarë disa rrugë që ju kanë mbetur pa asfaltuarë.

Mendoj që hyrat vetanake duhet direkt me i adresuar te qytetarët.Faleminderit.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përshëndetje për të gjithë!Në mbledhjen e kaluarë e kam cekur në fshatin Carrallukë që katër vite kanë vendosur zallë në asfaltë ose le të vijnë me larguarë ose le te shtrojnë edhe për ndrqim nuk jemi në rregullë gjendje shumë e keqe.

Drejtor z.Blerim dhe ju drejtor z.Avdi për atë që jeni përgjegjës është mirë me na dhënë një përkrahje.

Një pyetje e kam për kolegun z.Veton Zogaj nëse keni mundësi dhe guxoni me ja bërë një pyetje bashkëpartiakëve tuaj.

Në Carrallukë e keni bllokuarë tranzitin a guxoni ndonjëherë me bërë pyetje pse e keni bllokuarë?

Ju si parti e Lëvizjes Vetëvendosje që po pretendoni me marrë 80% dhe keni marrë vota shumë në Malishevë si subjekt politikë. Unë ju kam parë juve që vazhdimishtë keni dëshirë me kritikuarë por unë vetëm një pyetje e kam për juve. A keni guxim në partinë e juaj me bërë vetëm një pyetje për këto bllokime që janë bërë në Malishevë?

Veton Zoga(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Te rruga që kanë filluarë punimet Kijevë-Malishevë ajo kontratë është nënshkruarë, sipas ligjit për prokurim publikë secilën vonesë që e bënë kompania ajo ndëshkohetë për atë punë ajo e ka një kontratë që ka me realizuarë për një kohë të caktuarë, por ju betohem nuk e di qfarë do të bëhetë më tutje. Unë mendoj që pa tjetër do ta përfundojë brenda afatit kohorë sepse ka dhënë zotim dhe ka nënshkruarë në letër për atë punë, nëse nuk e realizonë do ta ndëshkojnë për atë qështje.

Sa i përket rrugës së tranzimit nuk e di sa jeni i informuarë z. Remzi jo vetëm që kam guxim me bërë pyetje por kam bërë kërkesë zyrtare edhe në Ministrinë përkatëse.

Rruga e tranzitit është bërë pa një planifikim të mirëfilltë dhe për këtë arsyeje ka hasur në vështirësi sepse ka shumë qështje procedurale të pronave që janë ende të pa zgjidhura komuna ka hyrë në projektë që aty figuronë pronë e shpronësuarë, komuna ka hyrë aty pa i zgjidhur qështjet pronësore. Fillimishtë duhet me bërë shpronësim për atë zonë pastaj me bërë investimin në atë rrugë, ata nuk kanë filluarë fare me shpronësimin.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ne nuk ju kemi penguarë për me bërë tranzitin aty në Carrallukë sepse është interesi pikërishtë i fshatit Carrallukë ju e keni bllokuarë pikërishtë Lëvizja Vetëvendosje ne i dim me emra dhe mbiemrat ata persona të cilët e kanë bllokuarë rrugën e tranzitit në Carrallukë.

Unë ju pyeta, a guxonit me pyetur pse e kanë bllokuarë? Sepse juve për debate nuk ka mundësi me ju mundur.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë i kam disa pyetje për bartjen e të hyrave vetanake e para jam duke e vërejtur që disa projekte janë duke u përsëritur do me thënë janë ndarë mjete për ato, herën e fundit kanë qenë në projektë buxhetin që janë votuarë për periudhën janar 2026-të.

Pika tjetër është tek renovimi i rrugëve lokale nëpër fshatra e vërejta që janë përmendur fshati Drenoc-Vërmicë, Carrallukë në mbledhjen e kaluarë e kam përmendurë që tek raporti i shpenzimeve janar-mars janë përmendurë të njejtat rrugë mirëpo kanë qenë me shumë prej 20,000.00€ po ashtu qështje tjetër është te të hyrat që janë bartur nga një projektë tek një projektë tjetër e vërejta që janë përmendurë vetëm me kode.

Cilat janë ato projekte që kanë dështuarë dhe nuk janë realizuarë?

Te renovimi i objekteve shkollore unë pajtohëm plotësishtë me parafolësin. Unë dëshirojë me ditur saktësishtë se qfarë keni nënkuptuarë në këtë rast me renovimin nëpër shkolla? Në objektet shkollore ka nevojë shumë për të investuarë dhe këto investimë do të ndikonin direktë në cilësin e arsimit. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj:Kërkojë nga Drejtori të na jep një shpjegim dhe interpretim sa i përket kërkesës që e parashtrori z. Burim Paqarizi që të përfshihenë edhe disa

projekte të reja. A lejohet ligjërishtë që të përfshihenë këto projekte nëse nuk janë parashikuarë në projektë buxhet për vitin 2026-të?

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Kryesus unë do të mundohem me dhënë shpjegim për secilin. Mjetet që krijohen tek të hyrat vetanake në arsim dhe shëndetësi jemi të obliguarë me i kthyer aty dhe ato nuk kemi mundësi me i tërhequr.

Kur e kemi aprovuarë buxhetin e keni parë se sheshi i ka pasur 1,210.000.00€ të planifikuara deri në muajin mars nuk kemi pasur alokim të buxhetit. Me rastin e alokimit të buxhetit përmbaruesit i kanë marrë 552,290.00€ prej sheshit për shkakë të kontratës kolektive do me thënë ne nuk jemi duke i shtuarë, ato para që i ka marrë përmbaruesi ata janë duke i vendosur në atë projektë.

Ky projektë mbylletë me këtë shumë më nuk ka mjete. Pranimi teknik është bërë në muajin janar dhe ky ka qenë projektë tre vjeçarë dhe ne në muajin janar është dashur me ja paguarë por nuk na kanë lejuarë deri në mars.

Të gjitha projektet janë egzistuese përjashtohen vetëm automjetet e komunës ky është projektë i ri janë të parashikuarë 50,000.00€ ka filluarë një automjetë procedurën dhe ka dalur më e madhe sipas kërkesës mirëpo drejtorja e administratës kanë kërkuarë që të përfshihenë edhe dy automjete gjithësej tri automjete 50,000.00€ plus 40,000.00€ që totali i bie 90,000.00€ për tri automjete zyrtare.

Renovimi i rrugëve lokale nëpër fshatra para praktikisht ju tregova që na kanë ardhur 250,000.00€ me ato mjete u përfundojke kontrata ne nuk e dimë punimet që janë përfunduarë sepse sipas obligimeve që i kemi ne në këtë projektë i kemi pasur edhe 250,000.00€ mirëpo pas mbledhjes së KPF-së është ekzekutuarë vlera prej 85,000.00€ në këtë projektë dhe ka mbetur vetëm kjo shumë obligim, pra jemi duke i kryerë obligimet dhe me këtë obligim përfundohet kontrata e renovimeve të rrugëve.

Projekti i ri për renovimin e rrugëve do të fillojë tani. Te asfaltimi i rrugëve e kemi një kontratë që nuk është përfunduarë dhe aktualishtë i kemi të planifikuara 200,230.00€ në rrugët siq janë në Carrallukë, Turiakë në Tërpezë e poshtme që janë përfunduarë vetëm pritët të shtrohet asfalti do me thënë 200,230.00€ kanë qenë të parashikuara i kemi shtuarë edhe 50,000.00€ që të mbulohet kontrata për pjesën që ka mbetur pa u mbuluarë. Këto rrugë kanë mbetur nga buxheti i vjetër.

Te kolektori i ujërave të zeza e kemi vendosur një shumë simbolike për me i ndihmuarë sepse në këtë vitë janë parashikuarë 500,000.00€ që do të realizohenë punimet por nuk e di a kanë filluar ende me punuarë.

Vitin e kaluarë kanë qenë 200,000.00€ kurse tani janë planifikuarë 500,000.00€ dhe kjo shuma tjetër 500,300.00€ do me thënë edhe 400,000.00€ mbeten për planifikim të buxhetit që i kemi për vitin 2026-të do me thënë përmbillet në vitin 2026-të në bazë të planifikimit që e kemi bërë.

Te kontrata e rregullimit të shtratit të lumit i cili është me planë të performancës të cilën e kemi pasur ne për obligim me përfunduarë në shumën prej 150,000.00€ besoj që edhe te kjo kontratë e kemi një vlerë rreth 100,000.00€ që të përmbillet kontrata vetëm nëse bëjmë tejkallim i të hyrave ose me rishikim të buxhetit.

Ne nuk mundemi me vendosur mjete në projekte të reja për ato të cilat janë planifikuarë dhe aprovuarë në Kuvend. Ju mundeni me vendosur për shembullë që janë planifikuarë shtatë milion euro për rrugë nëpër fshatra për tri vite që ju e keni aprovuarë nëse ju dëshironi me i shtuarë edhe 100,000.00€ për projekte të reja ajo duhet me kaluarë për miratim edhe në Kuvend të Republikës së Kosovës për me ndryshuarë.

Fillimishtë kërkesa për projektë të ri duhet me u miratuarë këtu në Asamble pastaj ajo kalonë në Kuvend për rishikim të buxhetit.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Kryesus për këtë egzistonë një fazë për planifikimin buxhetorë,në vitin e kaluarë është dashur të planifikohenë të hyrat dhe të krijohenë ato progarmet e investimeve.

Vitin e ardhshëm Drejtori duhet me na ndihmuarë për planifikimin e të hyrave vetanake për destinimin e tyre aty ku ka nevojë dhe jo me ardhur në një fazë që me krijuarë projekte të reja,sepse nëse kishin me qenë projekte në vazhdimësi në arsim,shëndetësi do të ishin më mirë.

Kryesus dhe Drejtor me mirëkuptimin më të madh jam duke thënë që të hyrat vetanake të planifikohenë dhe të jenë sa më direktë në shërbim të qytetarit.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Ne nga Dapartamenti i buxhetit kemi kërkuarë që mos me na kufizuarë kufirin e të hyrave,vitin e kaluarë e kemi pasur kufurin 1,500.00.€ kurse ne e kemi realizuarë 2,600.00€ .Për vitin 2027-të na ka ardhur qarkorja që ne duhet me përfunduarë deri në fund të muajit gusht e ky tejkalim i të hyrave,vitin e kaluarë është përfunduarë pas muajit shtatorë do me thënë katër muaj janë bërë tjekalim i të hyrave të cilat nuk kanë mundur me qenë të parashikuara sepse nuk e kemi ditur sa kanë me mbërijtur.

Unë kam kërkuarë që për vitin pasues ndonjëherë është më mirë mos me realizuarë shpenzimin e të hyrave qindë për qind se sa me tejkualuarë sepse neve po na shtyhet ekzekutimi i shpenzimeve për një vitë.Faleminderit.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Me sa e kemi parë shkresën për bartjen e të hyrave,qëndrojnë ato defektet por kur e vërejta te qështja e arsimit që ato mjete që krijohen nga kjo duhen me u kthyer aty tjetër mundësi nuk ka.

Unë e kam një kërkesë në të kaluarën në Malishevë nuk ka pasur ndërtime të larta dhe falë ndërtimeve të larta janë rritur këto tjekalime të hyrave buxhetore do të ishte mirë prej këtyre të hyrave që kanë ardhur prej lejeve të ndërtimit,prej ndrim destinimeve e të tjera të ju kthehenë në infrastrukturë qytetarëve të cilëve na kanë mundësuarë neve të rrisim buxhetin e të hyrave.

Të paktën kur e kemi buxhetin paraprakë apo rishikimin e buxhetit me gjetur një mundësi që me planifikuarë që edhe një pjesë e të hyrave që na kanë ardhur prej atyre bizneseve të ju kthehen atje.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kush është për që kërkesa e z.Burim Paqarizit i cili e paraqiti në foltore të kalojë?

Rezultati i votimit:5 për,15 kundër,0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi që nuk kalonë propozimi i parashtruarë nga z.Burim Paqarizi.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:E hedhi në tërësi kërkesën nr 04/254, datë 04.05.2026, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin fiskal 2026.Kush është për?

Rezultati i votimit:15 për,3 kundër,2 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave u miratua kërkesa nr 04/254, datë 04.05.2026, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin fiskal 2026.

Pika 6

Pika e gjashtë: Rishqyrtim i vendimit nr. 02/87 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/359, 6. datë 11.08.2022, për inicimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, konform shkresës zyrtare të MAPL-së, nr.020-742/17, datë: 04.05.2026.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Dokumentin e Ministrisë e keni para vetës.Hapi diskutimin për këtë pikë.

Bashkim Krasniqi((anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Kryesues e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kalurë,vjen shkresa e pasë e MAPL-së vetëm fleta e parë dhe në fund vendimi komunal është në kundërshtim me ligjin në fuqi.Ne e kemi votuar një vendim dhe është mirë me na ardhur edhe pjesa tjetër e shkresës me na treguar edhe arsyetimin pse është në kundërshtim qfarë kemi bërë.

Nëse ne kemi me bërë rishqyrtimin atëherë qfarë kemi me rishqyrtuarë sepse me këtë shkresë që e keni sjellur unë nuk e di se qfarë kemi me bërë sepse MAPL-ja ka shkruarë që vendimi është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi,shkresa tjetër të paktën mua në email nuk më ka ardhur por vetëm fleta e parë që shkruanë atë që e lexova nuk do ta përsërisë disa herë.

Do të ishte mirë të paktën administrata me na shpjeguarë pse jeni duke e dërguarë për rishqyrtim këtë vendim në Kuvend me na treguarë arsjet se qfarë kemi me rishqyrtuarë të paktën me na treguarë kur kemi gabuarë që mos me gabuarë prapë.

Do të ishte mirë që përveq që do të na shpjegoni verbalishtë me na shpjeguarë edhe me shkresë.Unë nuk jam duke e ditur se qfarë kemi me bërë me këtë kërkesë.Kryesues.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Te unë materiali është kompletë,ndoshta ka ndodhur ndonjë gabim teknik te ju.Kjo kërkesë ka të bëjë me rishqyrtimin e vendimit për shoqatën ”Jetimat e Ballkanit ”.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Në momentin kur e keni marrë vendimin në Asamble për me rritur sipërfaqën që edhe ato dy hektarë që i keni ndarë edhe ju keni qenë aty drejtor i drejtorisë nuk keni mundur me i ekzekutuarë për shkakë që nuk ka pasur

emërtim se për qfarë janë duke u ndarë, vetëm janë ndarë si parcellë dy hektarë ne nga viti pasues që e kemi rritur sipërfaqen nga dy hektarë i kemi bërë katër sipas kërkesës së OJQ-së "Jetimat e Ballkanit" është marrë ai vendim.

Me ju thënë të drejtën proceduralishtë dhe materialishtë me ato ligjet në fuqi ajo kërkesë nuk mundet të trajtohet në formën siq e kanë kërkuarë ata, MAPL-ja ka thënë që duhet me rishqyrtuarë vendimin sepse për OJQ është e rregulluarë për objektet që kanë me ju dhënë pronë publike deri një vitë por jo për 99 vite pronën e paluajtshme.

Për rastin konkretë për shoqatën "Jetimat e Ballkanit" një zgjidhje që e kanë bërë komunitat e tjera edhe ajo nuk ka qenë e ligjshme e kanë kombinuarë procedurën e ankandit së bashku me shprehjen e interesit përafërsishtë ky vendim ka me u bërë thirrje publike për shprehje të interesit pa i përmendur "Jetimat e Ballkanit" pastaj nëse merret vendim për hapje të shprehjes së interesit duhet me themeluar edhe një komision që ka i zhvilluarë procedurat e pastaj kjo OJQ ka me aplikuarë dhe me prezentuarë projektin e vetë njëjtë sikur që vlenë për bizneset apo për personat fizik.

Kuvendi komunal ka me ja caktuarë një qira vjetore në varet shumën të cilën e vendosin ata pastaj vjen në Kuvend ofrohetë si oferta më e mirë në Kuvend pastaj votohetë, bëhet konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe pastaj nënshkruhet kontrata.

Nuk është forma precize e specifikuarë me ligj siq është forma për shfrytëzim për prona publike por është një formë e kombinuarë në mes të ankandit publik dhe shprehjes së interesit. MAPL-ja nuk e ka shpjeguarë se si duhet me shkuarë ne për shkakë që i bie se e interpretonë ligjin e që nuk ka të drejtë me interpretuarë as Ministria e as ne.

Disa komuna si për shembullë komuna e Suharekës dhe komuna e Podujevës e kanë kryer në këtë formë e kanë shpallur si zonë e kanë shpallur thirrjen e interesit ka aplikuarë ojq-ja për shkakë që është një projektë shumë i rëndësishëm për komunën tonë dhe pastaj e kanë përzgjedhur të vetmën për shkakë që nuk ka pasur të tjera.

I kanë propozuarë Kuvendit pastaj Kuvendi e ka përcaktuarë tarifën dhe i ka dhënë leje për me zhvilluarë procedurën dhe me lidhur kontratën me Kryetarin.

MAPL-ja në një lloj forme na ka dërguarë atë formë sepse nuk ka ndonjë formë tjetër që e rregullonë këtë mënyrë se si po kërkohet për OJQ-në "Jetimat e Ballkanit".

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Ne e kemi diskutuarë këtë qështje edhe në KPF për faktin që është një interes i madh për komunën tonë dhe për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë tonë siq janë pleqtë, dhe fëmijët me nevoja të ndjeshme, unë e konsideroj që duhet me rishqyrtuarë vendimin tonë me vepruarë sipas kërkesës së MAPL-së. A duhet me themeluarë sot komisionin?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës): Nëse merni vendim dhe caktoni si zonë kadastrale që doni me dhënë për këtë qëllim me bërë thirrje publike për shprehje të

interesit,duhet me bërë komisionin sepse ligji e thotë që për secilin parcellë apo seclin vendim që e merrë Kuvendi duhet edhe një vendim i ri për komision.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ne sot nuk e kemi në rend të ditës themelimin e komisionit të ri.A mundemi me integruarë brenda kësaj pike a bie në kundërshtim me ligjin nëse brenda kësaj pike marrim vendimin dhe e themelojmë komisionin? A bie në kundërshtim me ligjin apo jo?Për arsyeje që mos me na u kthyer edhe njëherë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Ne e kemi edhe një problemë këtu për arsyeje që ne nuk e dim se parcella në fjalë a është pjesë e listës së pronave që ne kemi të drejtë me shpallur sepse këto probleme na ndërliken vazhdimishtë.Fillimishtë duhet me pasu listën e pronave që do të shpallen për vitin 2026-të,kështu që unë nuk jam i sigurtë ajo parcellë a është në listë për shkakë që ne ende nuk e kemi listën e miratuarë për këtë shkakë po ndërliken problemet njëra me tjetrën.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Nëse neve na kthehetë për shkakë që nuk është në listën e pronave ne nuk humbim asgjë sepse për këtë vitë ne nuk mundemi me përfunduarë këtë punë deri në vitin 2027-të për shkakë që kjo është një qështje me rëndësi.Por sa ma shumë që vonohemi është aq më keq për neve dhe për ato kategoritë të shoqërisë tonë.Nëse ne sot e marrim vendimin e formojmë edhe komisionin nëse e kthen MAPL-ja ne jemi duke humbur kohë,ndoshta do të ishte më mirë që ne sot me marrë vendimin dhe pas tri dite me mbajtur seancë të jashtëzakonshme po flasë në emër të grupit me mbajtur mbledhje dhe me zgjidhur këtë punë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):MAPL-ja nuk ka thënë që nuk keni të drejtë me marrë vendim mirëpo vendimin që e keni marrë duhet me përshtatur në harmoni me dispozitat ligjore.Pra nëse duhen ato dispozita duhet me shpallur atë zonë në shfrytëzim edhe themelimin e një komisioni që ka me i zhvilluarë procedurat,unë besoj që Ministria e kalonë për shkakë që edhe ata e dinë që nuk është në rregullë por nuk ka formë tjetër për me realizuarë atë investim për ato kategoritë që kujdeset ajo shoqatë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kush është për që të rishqyrtohet vendimi?

Rezultati i votimit:20 për,0 kundër,2 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua me shumicë të votave vendimi për Rishqyrtim i vendimit nr. 02/87 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/359, 6. datë 11.08.2022, për inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, konform shkresës zyrtare të MAPL-së, nr.020-742/17, datë: 04.05.2026.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Komisioni duhet me u përbërë prej pesë anëtarëve dy nga Asambleja,dy nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftoheni për me i propozuarë emrat.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Në emër të grupit NISMA propozojë z.Hafir Rexha.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Në emër të grupit të LDK-së propozojë znj.Xheneta Morina.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kush është për që të votohen këta dy emra nga Asambleja komunale?Pastaj emrat e tjerë dy nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile ti bashkangjiten këtij komisioni.

Rezultati i votimit:14 për,0 kundër,8 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se me shumicë të votave u miratua propozimi për themelimin e komisionit.

Pika 7

Pika e shtatë: Propozim për ndryshimin e Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Nuk e di a do të fillojmë për këtë pikë të rendit të ditës meqenëse Drejtori nuk qenka këtu apo dikush nga zyrtarët për të paraqitur rregullorën.Hapi debatin.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë në emrin tim personal dhe jo në emër të grupit sepse shefi e jep qëndrimin,mirëpo unë e konsiderojë që kjo rregullore është më se e vonuarë për qytetarët e komunës së Malishevës.

Ne e kemi një rregullore që e kemi në fuqi që nga viti 2010-të,Malisheva ka evoluar ka ndryshuarë ka nevojë për rregullore dhe për ndryshim edhe bizneset janë duke e mikëpritur këtë rregullore,unë personalishtë jam që kjo të trajtohet dhe ta marrë një epilogë.Faleminderit.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë e marrë me mirëqenie atë qfarë e tha z.Hafir Rexha sepse në kohën kur është bërë ajo rregullore ai ka qenë Drejtor i Inspektoriatit dhe i ka parë më në detaje nevojat që nevojiten.Në rregulloren e vitit 2010-të ka pasur disa rregulla që janë lejuarë me ligj kurse tani kanë ndryshuarë për shembullë kazinot dhe lojërat e fatit e kanë pasur orarin e caktuarë përderisa me legjislacionin e tanishëm në fuqi kjo veprimtari është e ndaluarë me ligj,pastaj sot ka disa aktivitete të reja që në atë kohë nuk ka pasur.

Nëse ka dikush nga anëtarët e Kuvendit pozitiv apo opozitiv ndonjë vërejtje për ndonjë pikë të caktuarë që mundemi me ja rishqyrtuarë përndryshe pse mos me miratuarë edhe ashtu nuk ka ndonjë ndryshim të madhë prej asaj të kaluarës.

Bashkim Krasniqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Kryesues këtu ka ardhur si propozim ndryshimi i rregullorës.Kush e ka sjellur a ka pasur komision?A është një drejtori apo kemi me dalur ne me ekzekutuarë si anëtarë të Kuvendit?Duke e pasur parasysh që asnjë drejtor nuk është i pranishëm këtu.

Kujt do të ja miratojmë këtë rregullore ne?Sepse dikush ka me zbatuarë këtë.Unë besojë që ka qenë shumë në interesë që me qenë prezentë këtu edhe nëse komisionë ka pasur që e ka hartuarë këtë rregullore ose në kuadër të drejtorisë që është bërë sepse besoj që bara më e madhe është në drejtorinë e inspektoriatit sepse vetëm me ardhur kështu me propozim për rregullore nuk më duket në rregullë edhe pse kjo si rregullore është e mirëseardhur sidomos për punëtorët.Faleminderit.

Veton Zoga(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesues.Unë pajtohem plotësishtë me atë që e tha z.Bashkimi.E para si format aty po shkruanë rregullore mirëpo është dashur me qenë draftë rregullore sepse rregullore është vetëm kur e miratojmë ne në Kuvend. Unë pajtohem që është dashur me qenë komisioni që me ditur a ka qenë në dëgjim publik ky draftë a ka pasur vërejtje prej palës së tretë në këtë rast prej qytetarëve,shoqërive civile apo grupeve të tjera të interesit sepse pastaj po i bie se jemi duke i miratuarë shpejtë e shpejtë dhe pastaj ajo mbetet dhjetë apo njëzetë vjet dhe nuk dihet a ndryshonë më.

Ndoshta nuk është mirë me u nxituarë nëse keni pritur deri tani me prituri edhe sponsorizuesin komisionin apo drejtorin në këtë rast me ardhur dhe me na dhënë disa shpjegime sido që të jetë ne jemi të gatshëm me trajtuarë.

Unë i kam edhe disa pika që i kam evidentuarë si vërejtje për shembullë neni i 15 i rregullorës me të cilën thotë orari i punës për barnatore,ordinanca private.Unë në të kaluarën nuk jam pajtuarë që me punuarë vetëm një barnatore pra me kujdestaruarë sepse është shumë pak sidomos edhe kur janë mërgimtarët këtu sepse e vështirësonë këtë punën për qytetarët që kanë nevojë,kështu që unë mendoj që duhet me i pasur disa ndryshime.Nëse vendosni me shqyrtuarë do ti përmendi edhe disa vërejtje të tjera.Faleminderit shumë.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Kjo rregullore është e mikëpritur për grupin parlamentarë të LDK-së,ka qenë nevojë dhe kërkesë e punëtorëve veqanarishtë në super markete.Unë e kam një qështje te neni 5 i kësaj rregullore kur fletë për orarin e punës të qendrave tregëtare të marketeve të super marketeve dhe dyqaneve tregëtare ushqimore të pijeve dhe duhanit orari i punës është që të fillonë prej orës 07:00 në mëngjesë deri në ora 21:00 të mbrëmjes kurse paragrafi 5.4 në ditën e diell nga drejtorja e inspektoriatit caktohet të

punojë në kujdestari vetëm një super market në Malishevë dhe rendi i kujdestarisë do të bëhet me rotacion,unë e kam një pyetje.

A i plotësonë nevojat e më shumë se 40,000 banorëve që të jetë e hapur vetëm një super market gjatë ditës së diel?

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Për këtë qështjen e fundit që e ka ngritur z.Fitimi ka pasur debatë dhe është tërhequr dhe nuk është votuar për as kundër.Procedurat e dëgjimit publik dhe të gjitha konsultimet i ka kaluarë jemi në fazën e votimit dhe është e padrejtë që nuk është prezentë drejtori apo dikush nga zyrtarët,mirëpo ne po vazhdojmë me trajtuarë duke i marrë opinionet.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Fakti që nuk është prezentë prezantuesi është për keqardhje mirëpo ne nuk mundemi me i penalizuarë dhe me i lënë këto biznese pa një rregullore për shkak që nuk është dikush nga drejtoritë e inspektoriatit këtu sepse përndryshe është dashur me anuluarë.

Në mandatin e kaluarë e kemi diskutuarë shumë qështjen e punës për ditën e diel.Por pas liberalizimit të vizave shumicës ju ka dhënë rasti me dalur në vendet Evropiane por nëse nuk i blenë disa gjëra ditën e shtunë të dielën jo një por asnjë market nuk punën.

Kjo rregullore për mu është më e përshtatshme për shkakë të punëtorëve të thjeshtë sepse edhe ata duhet me pasur një ditë pushim.Shpeshë herë bizneset tona për shkakë të egos i detyrojnë punëtorët me punuarë sa më shumë, z.Fitim ndoshta dalë nga dale do të edukohenë qytetarët,besa kur të edukohenë mirë kemi me jau mbyllur që mos me pasur market të hapur ditën e diel e me u mësuarë që ditën e shtunë me u furnizuarë,nga dalë dale edhe ne me hyrë në botën e civilizuarë.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Kjo rregullore në legjislaturën e kaluarë i ka kryer të gjitha procedurat e dëgjimet publike edhe ka qenë komisioni.Rregullorja është më se e nevojshme unë kam qenë Drejtor i Inspektoriatit për katër vite dhe kemi pasur shumë pengesa për me krijuarë rend edhe rregullë në qytetin tonë për shkakë të evolimit të qytetit të Malishevës.

Disa vite më parë në Malishevë kur është bërë ora 19:00 ka shkuarë autobusi i fundit me nxënës dhe nuk kemi pasur asnjë zhvillim të veprimtarisë,sot ka ndryshuarë Malisheva,sot prej qyteteve të tjera vijnë në Malishevë për vizitë është më se e nevojshme ndryshimi i rregullorës.

Punëtorët që punojnë në sektorin privat janë të privuarë nga e drejta e tyre e punës për arsyeje se nuk kanë asnjë ditë pushimi.

Ne jau mundësojmë përmes votës tonë që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha amvisërit dhe të gjitha objekteve afariste lokale që janë të precizuara për secilën veprimtari që zhvillohet në komunën e Malishevës përjashto gastronomin,janë në detaje edhe për frizerët dhe për secilën kategori është e precizuarë.

Ne më parë nuk kemi pasur autolarje apo vetë autolarje siq po i quajnë tani,në Malishevë nuk ka pasur tani i kemi me dhjetra edhe për ato është specifikuarë rregullorja kështu që për me bërë pak më të lehtë fushë veprimtarinë e drejtorisë së inspektoriatit dhe inspektoriatit kjo rregullore kërkonë plotësim ndryshimin pajtohem me z.Vetonin që tha kjo duhet me qenë draftë.

Unë ju thrrasë që ta mbështesim dhe të jemi sa më afër qytetarëve sepse qytetarët na kanë sjellur këtu.Faleminderit shumë.

Burim Paqarizi(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Pajtohem edhe unë me kolegët me qështjen e aspekti juridik se se si duhet quajtur kjo rregullore e cila do të ndryshohet. Kjo rregullore është jashtëzakonishtë e rëndësishme për punëtorët që punojnë në biznese.Në mandatin e kaluarë e kemi diskutuarë këtë qështje për marketet.

Unë pajtohem me z.Halilin që tha atje në perendim ditën e diel nuk punojnë,mirëpo ne ende ndoshta nuk e kemi kulturën se si veprojnë shtetet perendimore,mendoj që ne ende nuk e kemi arritur atë standardë të jeteses që me i kryerë shërbimet vetëm brenda dy apo tri dite gjatë javës dhe me i pasur dy ditë pushim në javë.

Shumë familje kanë probleme financiare dhe ndoshta ditën e diel e kanë pushim dhe atë ditë me qenë mbyllur marketi do të ishte shumë sfiduese që ata të furnizohen me gjëra ushqimore,ndoshta mundet me na interpretuar edhe z.Muharremi qështjen e super marketeve.

Disa barnatore nganjëherë pritojnë me mbajtur ndrimin e kujdestarisë për shkakë të orarit të zgjatur sepse është punë e lodhur për ata.

Unë e kisha pasur një propozim për super marketet që ato të punojnë në zona të caktuara në Kijevë të punojë një supermarket sepse do të ishte shumë largë ai me ardhur në Malishevë ose një market me qenë i hapur në Banjë dhe ai nga Kjeva me ardhur në Banjë është no sens ose ai do të shkojë në Klinë me u furnizuarë.Kjo ndoshta nuk është mirë për bizneset tona lokale

Ne e kemi mundësinë me ndarë në katër pjesë Malishevën zona e Banjës,Carrallukës,Kijevës, Astrazubit,Dragobilit që së paku nga një super market me punuarë do të ishte më e logjikshme se sa me i mbyllur të gjitha marketet dhe me punuarë vetëm një market,sepse prej katër fshatrave me shkuarë me u furnizuarë në një marketë ndoshta është sfiduese dhe do të ishte mirë me analizuarë në kordinim së bashku.Faleminderit.

Valjeta Hoti (anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesues.Vetëm se u përmendën shumica e gjërave por ajo qfarë e vëreja,nuk jam duke e ditur këtë pjesën e konsultimeve mirëpo jo gjdo biznes ka me u pajtuarë me këtë rregullore.A do të ketë afat të ankesave?Kush do ti shqyrtonë këto ankesa?Kjo rregullore nuk fletë për afatet.Te dispozitat ndëshkuese direktë fletë për gjobat por para gjobave a ka me pasur paralajmërime?Besojë që është e drejtë e tyre me ditur këtë pjesë.Faleminderit.

Veton Zoga(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Me vetë faktin që e filluamë diskutimin, shumë gjëra janë duke dalur në pahë dhe ne nuk duhet me u nxituar në këtë draftë rregullore sepse e lehtë është me marrë vendim mirëpo mundet me pasur probleme të reja. E para në thirrjen që ju ka bërë kësaj rregullore ju ka referuarë ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për tregëti, statutit të komunës por e ka haruarë ligjin kryesor ligjin e punës.

Te precizimi i orarit të punës mendoj që i ka ofruarë një zgjidhje vetëm te punëtorët e super marketit që i ka kufizuarë përshembullë prej orës 08:00 deri në ora 17:00 apo si ishte e përcaktuarë, mirëpo orari i njejtë ka mbetur te gjelltoret te restorantet ka mbetur orari i njejtë prej orës 08:00 deri në ora 20:00 është një lloj diskriminimi.

Unë e kam një propozim nuk isha nxituar me nxjerrë një vendim pa u shtjerur mirë debati. Do të ishte mirë komisioni me na sjellur debatet që kanë pasur dhe kërkesat me i shqyrtuarë një herë mirë ato raporte.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Nuk ka dyshim që ne kemi me lënë diqka keq nëse vërehet qe diqka është keq ne pas dy ose tri seancave mundemi me ndryshuarë prapë. Kjo është rregullorja jonë dhe ne nëse e vërejmë që diqka kemi gabuarë e kthejmë prapë për me ndryshuarë. Kërkesa që e parashtroi z. Burimi ka sens sepse Kijeva dhe Malisheva janë largë njëra prej tjetrës por ato munden me lënë një orarë të kujdestarisë për market në Kijevë, gjithashtu edhe për farmaci vlenë njejtë, kurse Banja, Astrazubi e të tjera munden me ardhur në Malishevë.

Unë mendoj që kërkesa e z. Burimit ka logjikë dhe ne mundemi me miratuarë me këtë ndryshim të vogël që me lejuarë në Kijevë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Kërkesa e z. Burimit është më e madhe ai nuk e patën fjalën që me lejuarë vetëm një market por për katër markete në Malishevë. Kërkesa e z. Burimit është ndryshe nga kërkesa e z. Halilit.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Kërkojë falje Kryesues sepse ndoshta me të vërtetë e kemi shtjerur debatin për këtë pikë. Te qështja e barnatoreve në qytetin e Malishevës ato janë biznese private ne nuk kemi mundësi me i obliguarë për me kujdestaruarë për me punuarë. Për mos me punuarë kemi mekanizëm.

Kjo ka qenë më shumë qështje vullnetare që duhet me falenderuarë publikishtë që ka punuarë vetëm barnatorja Triti- Pharm ajo ka mbajtur ndrimin e kujdestarisë edhe në kohën kur ka pasur më shumë mërgimtarë në kohën e dimrit dhe verës.

Në kohën e verës ka pasur kërkesa nga barnatorët që kanë dashur me mbajtur orarin e kujdestarisë mirëpo jo ju kemi ndaluarë sepse për me hyrë duhet me bërë edhe atëherë kur nuk ki shitje.

Do të ishte mirë e marë që këtë rregullore me zbatuarë një market nuk është largë sepse munden me u furnizuarë të shtunën.

Për me rregulluarë orarin drejtoria e inspektoriatit është e obliguarë me mbajtur takime me bizneset afariste dhe me i përcaktuarë këto orare për rotacion.

Në fillim kjo është pak e vështirë por është shumë e nevojshme.

Burim Paqarizi(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Ne jemi për gjdo ditë në terren dhe i kemi parasyshë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.Ne jemi për me mbrojtur interesat e punëtorëve sepse për këtë arsyeje jemi të thirrur këtu,mirëpo me punuar vetë një market është shumë pak për nevojat e qytetarëve.

Unë mendoj që ne ende nuk e kemi arritur standardin jetësor,ne në Malishevë njihemi si vend i varfër dhe mendoj që të dielën e kanë pushim shumë punëtorë të sektorit privat dhe ata obligimin kryesor e kanë ndoshta me u furnizuarë.Meqenëse Malisheva ndahet në katër rrugë do të ishte një ndarje proporcionale e afërtë për ta.Faleminderit.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Unë e kam frikën që duke i mbrojtur punëtorët e marketit po i diskriminojmë punëtorët e ndërtimit në këtë rast po i marrë shembullë këta.Ata punojnë nga e hëna deri të shtunën dhe e presin ditën e diel që me u shërbyerë për nevojat familjare.

Kjo rregullore që është hartuarë nga komisioni besoj që e kanë pasur parasyshë gjendjen sepse kur flasim për super market kemi parasyshë që fjala është për marketet e mëdhaja nëse i mbyllim sytë dhe i kujtojmë rrugët që shkojnë në Malishevë-Dragobil ne të gjithë e dimë se janë dy super markete të mëdhaja nëse e shikojmë rrugën Malishevë-Banjë ne dim që janë dy super markete të mëdhaja e njejta është edhe një super market në Kijevë-Malishevë dhe janë dy super markete të mëdhaja që fillojnë prej rrugës Malishevë e që shkonë për Arllat.

Propozimi është i imi që Komuna e Malishevës mos të jetë e hapur vetëm me një super market ditën e dielë por të jenë së paku dy për shkakë që me ju dhënë hapsirë dhe mos me pasur ngarkesë.sepse secilit market i bie gjdo një muj e gjysmë me mbajtur.Ka super markete shumë të jenë minimuni dy super markete të hapura të dielën.Sa i përket orarit të punës është inspektoriat i cili e mbikqyrë orarin e punëtorëve.Faleminderit.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Diskriminimi më i madh ju bëhet punëtorëve që punojnë sektorin privat që punojnë ditën e diel,unë asnjë market nuk e kisha lejuarë me punuarë ditën e diel asnjë market nuk e kisha lejuarë vendimin e kisha marrë nëse e kisha pasur fuqin e votës.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Dëshirojë me u ndërlihur vetëm pak te fjalimi i z.Fitimit.Punëtorët në ndërtim nuk punojnë deri në ora 11:00 e natës,ata e përfundojnë punën po e supozojmë në ora 17:00 dhe ka hapësirë me u furnizuarë dhe

nuk i cenohetë e drejta.Me dashur secili prej neve mundet me gjetur kohë.Kështu që për me hartuarë më mirë dhe më marë orarin është me lejuarë një marketë që mos me krijuarë ngatëresa.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Janë paraqitur dy propozime të z.Burimit dhe z.Fitimit a qëndroni mbrapa këtyre propozimeve apo dëshironi me i hedhur në votim?Apo jeni duke i harmonizuarë sepse e keni të njejtin mendim.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Do të ishte mirë me bërë një konsulltim me shefat e grupeve parlamenatre sepse është interesë i përgjithshëm nuk është qështje individuale.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Për me implementuarë orarin është një qështje shumë e vështirë ashtu siq e tha edhe Kryesusi ne kemi për shembullë markete me emrin Pajtim.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Unë mendoj që Asambleja komunale duhet me pasur fuqi të votës dhe me qëndruarë në ballë të veprimeve të sajë dhe qëllimi gjdo herë duhet të jetë në shërbim të qytetarëve të saj në krijimin e lehtësirave për të gjithë qytetarëve e komunës së Malishevës.Në rrethanat aktuale nëse mundet me qenë e gabuarë ne mundë të kërkojmë pak ndryshim dhe përmirësim të rregullorës.

Mirëpo duke i parë qëndrimet politike idetë individuale në Asamble komunale mendojë që duhet me i konsumuarë me dëgjime publike dhe gjdo procesë demokratikë deri në procesin e votës është mendim në momentin që votohet është vendim.

Unë kisha kërkuarë që për me pasur një mendim unik me dalur në pauzë prej 5 minutave me shefat e grupeve parlamentare në zyrën time.

Pauza: 11:50

Fillon: 11:55

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Falenderojë të gjithë shefat e grupeve parlamentare të cilët ishin prezentë.Urojë që komisioni të ketë punuarë drejtë dhe sipas ligjit dhe mos të kemi probleme nga ana e MAPL-së që të na kthejë rregullorën.Ne në të pajtim të plotë me shefat e grupeve parlamentare u rekomanduamë të votojmë në këtë formë ashtu siq është dhe pastaj nëse e shohim ka pakënaqësi nga qytetarët ne prapë e trajtojmë.Kush është për?

Rezultati i votimit:22 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua propozimi për ndryshimin e Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës.

Pika 8

Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/110, datë 10.04.2026, për inicimin e procedurës për kompensim të pronës.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj: Për këtë pikë nuk e kemi materialin e kompletuar. Hapi debatin për këtë pikë.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Këtë pikë e kemi diskutuar edhe në fillim të rendit të ditës. Për këtë pikë i kam dy arsyeje pse duhet me shtyrë këtë pikë e para është sepse kërkesa ka ardhur e pa plotësuar dhe e dyta drejtoria përkatëse që duhet me na dhënë shpjegimet e nevojshme nuk është këtu. Kështu që edhe nëse njëra do të ishte e plotësuar e tjetra jo do të duhej me shtyrë këtë pikë.

Unë si anëtarë i grupit Nisma kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme.

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Kryesues sa i përket kësaj kërkesë unë jam duke parë mirëpo pa marrë parasysh se qfarë shkruanë këtu, ka shumë qështje të tjera që duhet me ja bashkangjitur kësaj kërkesë.

Ne duhet me pasur parasyshë diçka që gjdo kërkesë e cila vie jo gjdo herë një qytetarë mundet me ditur se si shkojnë procedurat dhe qfarë duhet me ofruarë dhe pastaj duhet me u marrë administrata e Kuvendit apo administrata e komunës që me udhëzuarë palën ose me i treguarë palës se cilat dokumente i mungojnë dhe mos me ra pre e pa dijes që me ju bartur kërkesa nga një seancë në tjetrën.

Këtu vërehet që i ka shkruarë disa shifra, kërkesa nuk është e pa bazuarë mirëpo unë mendoj që është mirë me ju drejtuarë me shkresë drejtorisë përkatëse por edhe palës që do me thënë me u kompletuarë kjo kërkesë dhe pastaj me u shqyrtuarë, pastaj se a do të mirtahohet apo jo është qështje tjetër.

Vetëm duhet me pasur parasyshë jo gjdo herë një kërkesë e palës me ardhur bllanko pa e udhëzuarë palën për dokumentet tjera përcjellëse që duhet me mbështetur kërkesën. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj: Për këtë kërkesë dhe dy të tjera kam kërkuarë direktë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastë që me kompletuarë kërkesën. Drejtori ka qenë në zyre tha këtë e kam marrë me mirëqenie se do ti kompletojë dokumentet dhe do ti sjelli në Asamble komunale. Për fat të keq nuk është bërë kompletimi i dy lëndëve më herët dhe as i kësaj. Realishtë nuk është përgjegjësi fare e Kryesuesit të Asamblesë komunale ti ndjekë lëndët kërkesat e qytetarëve për trajtim në Asamble komunale. Unë mendoj që pala përmes obligimit të zyres së gjeodezisë të kompletojë lëndën dhe pastaj të vie në Asamble komunale.

Unë nga kjo foltore në cilësinë e Kryesuesit kërkojë nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit ti sjellin sa më shpejtë dokumentacionet, sepse unë nuk kam nevojë sepse unë nuk di se qfarë me i kërkuarë palës.

Kërkesa e z. Halilit është që me u shtyrë kjo pikë e rendit të ditës. Kush është për?

Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër, 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua propozimi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika 9

Pika e nëntë: Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: A ka shqetësime apo kërkesa nga anëtarët e Kuvendit që dëshirojnë me ngritur për qytetarët.

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Kryesues nuk është qështje që nvaret prej teje por mendoj që është mirë që ne kur flasim ta kemi përballë këtë pjesën e drejtorëve kjo është një vërejtje sepse është jo serioze kur nuk janë drejtorët të pranishëm.

Janë disa pika me të cilën këto pika ka me i zbatuarë ndonjëri dhe ka me u marrë me këto vendime. Unë i përkasë pozitës unë kam qenë në të kaluarën Drejtor mirëpo më ka ndodhur me munguarë vetëm një herë apo dy herë. Unë kam qenë aty dhe i kam dëgjuarë të gjitha debatet që janë zhvilluarë në Asamble për dy mandate rradhazi.

Kryesuesi i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Unë kam kërkuarë nga ekzekutivi me qenë prezentë kur të mbahenë seancat.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 4 të rregulltë të Kuvendit të Komunës në ora 12:10.

Malishevë

Procesëmbajtësja

Kryesuesi i Kuvendit

Fatlume Delija

Fatmir Ademaj

